AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Infermieri"**

**ofruar nga**

**Institucionit të Arsimit të Lartë**

**"Universiteti Europian i Tiranës"**


Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Elda Panariti (Nuni)
2. PhD. Etleva Rustami


Tetor/2022

**Për Programin e studimit Bsc në "Infermieri" ofruar nga Universiteti Europian i Tiranës**

| Nr. | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti Europian i Tiranës |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Bachelor në "Infermieri" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | UMASR Nr. 542 datë 10.09.2018 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | - |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Parë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 3 vite/ 6 semestra |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 180 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | 6 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 10 PAE/ 2PAK v.a. 2018-2019<br>15 PAE/ 8PAK v.a. 2019-2020<br>31 PAE/ 2PAK v.a. 2020-2021 |
| 18 | Numri i studentëve: | 28 Studentë v.a. 2018-2019<br>103 Studentë v.a. 2019-2020<br>73 Studentë v.a. 2020-2021 |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

# TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

## Përshkrim përmbledhës

Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në "Infemieri" është hapur me Urdhër të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 542 datë 10.09.2018. Ky program mbulohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, në Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike, të Universitetit Europian të Tiranës, i akredituar me Vendim BA Nr. 46, datë 05.07.2019.

Programi i studimit është emërtuar dhe organizuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të njësisë kryesorë të institucionit të arsimit të lartë, si pjesë e sferës së mjekësisë. Përsa i përket strukturës dhe organizimit ky bachelor është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, sipas të cilit lëndët ndahen në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore / integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse.

Programi i studimit realizohet me 180 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademik (6 semestra), në përfundim të të cilit studentët pajisen me diplomë të ciklit të parë të studimeve në "Infermieri".

Objektivi kryesor i këtij programi është formimi i ekspertëve dhe specialistëve në aspektet teorike, praktike dhe aplikative në mjekësisë dhe më specifikisht në atë të infermieristikës. Programi i studimit Bachelor në "Infemieri" është hapur në vitin 2018 dhe për vitin akademik 2018 – 2019, në këtë program janë regjistruar 28 studentë. Në vitin akademik 2020-2021, kur edhe Institucioni ka aplikuar për akredititmin e këtij programi studimi, rezultojnë të jenë rregjistruar 73 Studentë për herë të parë.

## Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

ASCAL bazuar në "*Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017*" ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Universiteti Europian i Tiranës, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Bachelor në "Infermieri". Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Dr. Elda Panariti (Nuni) dhe PhD. Etleva Rustami, të dyja të specializuara në fushën e infermierisë. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga korditnatori teknik i ASCAL, Msc. Muhamed Prezja.

Në datën 18.02.2022, ekspertëve të jashtëm iu vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktua edhe agjenda e vizitës në institucion, e cila u zhvillua në datën 24.03.2022 në ambjentet e UET. Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas agjendës së planifikuar. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 07.04.2022.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standarteve të përcaktuara nga ASCAL, në kuadër të procesit të Akreditimit. Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe kryhet një analizë SWOT mbi programin e studimit që akreditohet. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Më datë 06/09/2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 87/95 Prot, datë 06/09/2022 dërgohet në Institucion Draft- Raporti i vlerësimit të jashtëm. IAL përcolli komentet përmes AMS më datë 20/09/2022 dhe me shkresë zyrtare Nr. 120/20 Prot, datë 23.12.2021.

**GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft- Raportin, sqaron si vijon:**

1. **Standardi I.4, kriteri 1, (Haset dhe në Standartin III.2, kriteri 1)**

**Koment nga Universiteti:** Shtimi i personelit akademik me grada dhe tituj shkencore, ka qenë vazhdimisht në krye të axhendës së vet Fakultetit. Në këtë drejtim, krahas mungesës së mundësive për kualifikime në studimet e ciklit të tretë e më tej gjatë viteve të fundit, vështirësitë në rekrutimin e tyre kanë qënë të lidhura edhe me faktin se mjekët/infermierët e kualifikuar nuk pranojnë me lehtësi të ndjekin një karrierë akademike, ndërkohë që e ndjejnë veten më komod në institucione spitalore dhe klinikat private.Përsa i perket praktikës, Universiteti ka bërë të mundur zhvillimin e tyre pranë institucioneve spitalore dhe angazhimin e stafit infermieror për t'i ndjekur ata gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti formues.

**Vlerësimi i ekspertëve të GVJ:** Sidoqoftë, GVJ mendon se duhen shtuar personel akademik më shumë, me gradë dhe tituj në fushën e Infermierisë, si dhe të shtohen përpjekjet e institucionit me pasurimin e laboratorëve brënda institucionit, në funksion të praktikës së studentëve. (GVJ i qëndron vlerësimit të saj)

2. **Standardi II.1 / /Kriteri 2, (Haset dhe sandardi II.3/ Kriteri 2 dhe 6)**

**Koment nga Universiteti:** Ne formatin aktual të hartimit të programit lëndët, laboratoret mund të evidentohen në seksionin "Metoda pedagogjike e përdorur në seminarin e radhës ". Megjithatë, mirëpresim sugjerimin mbi evidentimin më të qartë të orëve të laboratorit dhe në programet lëndore, ku sic; është bërë e ditur dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga vizita e eksperteve, ato pasqyrohen ne regjistrat përkatës.

**Vlerësimi i ekspertëve të GVJ:** Përsa i përket hartimit të programit dhe detajimit te tij në syllabuset e lëndëve, në syllabus duhet të pasqyrohet çdo orë e lëndës, leksion, seminar, laborator, praktikë mësimore. GVJ ka qënë shumë i vëmendshëm dhe i qëndron mendimit që pasqyrimi në syllabus i orëve dhe temave të laboratorëve dhe orët e praktikave është kriter dhe shumë i domosdoshëm për studentin.

3. **Standardi II.4 / Kriteri 4 dhe 5**

*GVJ ka vënë re që shpërndarja është më shumë orë teorike dhe jo e balancuar me orët praktike dhe kjo është e evidentueshme me cdo kurrikul tjetër të vëndeve në zhvillim dhe e theksojmë pasi kjo çon në mos arrtjen e objektivave dhe aftësimit profesional.*

**Koment nga Universiteti**: Bazuar në planin mesimor të programit Ba në Infermieri, paraqiten orët praktike në total 1049 dhe orët teorike në total 999 të cilat qëndrojnë në favor më së shumti

të orëve praktike, ndryshe nga cfarë komenton GVJ. Megjithatë, nisur nga paqartësitë që shfaqen dhe diskutimet gjatë vizitës së Eksperteve, Departamenti ka nisur punën për rishikimin e kurrikulës dhe planit mësimor të këtij programi studimi, duke rialokuar kreditet e praktikave lëndore në disiplinat e mëvetshme të formimit karakterizues (B), të cilat do të zhvillohen cdo semestër pranë pavioneve spitalore duke bërë kështu të mundur evidentimin me të qartë të ngarkesës mësimore të praktikave lëndore, krahas praktikës profesionale që aktualisht është pjesë e programit.

**<u>Vlerësimi i ekspertëve të GVJ:</u>** Përsa i përket Programit të studimit GVJ, ka thënë që është organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Europian të Tranferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) edhe pse vihet re që në kurrikulën ekzistuese kreditet, kanë një mos përputhje me legjislacionin vendas në fuqi për sa i takon orëve që i takojnë cdo krediti ne auditor/jashtë auditori, si edhe krediteve semestrale të ndryshme nga 30 (që kërkon ligji).

4. **Standardi II.4// Kriteri 8, Standarti II.5 / Kriteri 5, Standarti III. 2 / Kriteri 1, Standarti III. 3 / Kriteri 7, Standarti III. 7 / Kriteri 1 dhe 6**

**<u>Koment nga Universiteti:</u>** Ashtu si dhe kemi sqaruar edhe gjatë takimeve që kemi pasur me GVJ, gjatë vizitës në institucion, orët e praktikës ndërlëndore zhvillohen në fund të cdo semestri, duke nisur nga viti idytë akademik, në ambjentet spitalore/qendrat shëndetësore me të cilat Institucioni ka marreveshje. Në këtë mënyrë i jepet mundësia studentëve që të realizojnë më së miri aspektin praktik të lëndëve të profesionit në ambientet e duhura, duke ndihmuar rritjen e aftësimin professional dhe realizimin me cilësitë objektivave të studimit. Përsa më sipër, sqarojmë gjithashtu që ambjentet laboratorike pranë institucionit janë në dispozicion të studentëve për realizimin e orëve laboratorike të lëndëve bazë e disa lëndëve karakterizuese të programit. Madje në ndihmë të realizimit sa më mire të programit UET ka investuar në teknologji të reja sic është Laboratori i simulimit virtual, VR, shumë i rëndësishëm për studentët e Infermierisë në lëndët e Biologjisë dhe Anatomisë.

**<u>Vlerësimi i ekspertëve të GVJ:</u>** Përmbajtja e programeve të studimit mundëson në përfitimin e njohurive si teorike ashtu dhe praktike. Por ne mbetemi të mendimit dhe theksojmë faktin që përsa i përket laboratorit të bazave të Infermierisë, është e nevojshme parja e ambjenteve, pasi numri i studentëve, ka të nevojshme, më shumë se një laborator. GVJ e konsideron këtë hapsirë si jo mjaftueshëm për të kryer praktikën bazave të infermierisktikes. Po ashtu dhe praktika klinike që bëhen në Qënrat Shëndetësore Parësore, Dytësore dhe Terciare nuk i përmbush numrin e nevojshëm të orëve për studentët. Përmbushja me saktësi e këtij kriteri do të mundësonte punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.

5. **Standardi II.5 / Kriteri 1; 2; dhe 3, (Haset dhe në Standartin III.2 / Kriteri 4), (Haset dhe në Standartin III.4 / Kriteri 3), (Haset dhe në Standartin IV.2 / Kriteri 4)**

**<u>Koment nga Universiteti:</u>** Mbi konstatimet e Ekspertëeve për angazhimin e personelit akademik në programin e studimit, sikurse kemi evidentuar në përfundimet e vlerësimit të brendshëm, GVB dhe vet UETe konsideron një nga pikat e veta të forta angazhimin e personelit akademik në këtë program studimi.

Nuk është e qartë se cilit model apo cilave praktika kombëtare dhe/apo ndërkombëtare i referohet GVJ për detyrimin se në programin e Infermierisë duhen angazhuar vetëm pedagogë të diplomuar në te njëjtën fushë, ndërkohë që në dijeninë tonë nuk aplikohet detyrimisht një model i tillë në ndonjë nga institucionet e arsimit të lartë në vend apo jashtë tij.

Duke qenë se një nga objektivat kryesor të këtij program studimi është të pergatisë infermierë të përgjithshëm që të jenë në gjendje të ofrojnë kujdes shendetësor për cdo patologji dhe grup-moshe, të aftë si teorikisht ashtu dhe praktikisht si dhe duke patur parasysh aspektin shkencor të formimit të tyre, Departamenti ka angazhuar vazhdimisht personel akademik në përshtatje me ekspertizën përkatëse ashtu si psh. Mjeku kirurg për kirurgjinë, Anestezisti për lëndën anestezi, e kështu me rradhë përpërcjelljen e njohurive shkencore në auditor duke patur bindjen se aspektet teorike të trajtimit të patologjive të ndryshme zhvillohen mësëmiri nga mjeku ekspert I fushës përkatëse (OW: Ref. Nr. 02. Tabelat permbledhese -Tablelat 12.1 I 12.2 I 12.3 dhe Ref. Nr. 20. CV e stafit akademik). Ndërsa në funksion të formimit dhe aplikimit praktik të njohurive mbi kujdesin infermieror, stafi infermieror ka qenë pjesë përbërëse e stafit akademik të programit të studimit ndër vite qoftë me angazhimin në leksione në lëndët bazë (psh. "Bazat eInfermieristikes"), seminare si pedagog i brendshem (efektiv), i jashtëm (me kontratë) dhe i ftuar si dhe në formën e koordinatoreve të praktikavetë kontraktuar nga UET, për zhvillimin me cilësi të praktikave ndërlëndore dhe profesionale. Gjithashtu sqarojmë ashtu si dhe e bëmë të ditur gjatë takimeve që literature e detyruar dhe e rekomanduar pjesë përbërëse e syllabuseve të lëndës është zgjedhur në pershtatje me lëndën përkatëse dhe Programin e studimit infermieror. Madje kjo konsiderohet një pikë e fortë edhe nga GVB në Raportin e vetëvlerësimit. Për më tepër, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë çdo fillim viti akademik të rishikon syllabuset e lëndëve, të cilat pasi vlerësohen jo vetëm nga pedagoget për sa i përket përmbajtjes, formatit, literatures së propozuar, por miratohen edhe nga përgjegjësi i grupit mësimor dhe nga drejtuesi i Departamentit në mënyrë që të reflektojnë përditësime me qëllim arritjen në mënyrë optimal të objektivavetë studimit, e gjithnje sipas formatit te miratuar ne nivel institucional.

Sa më sipër, lutemi të rishikohet vlerësimi për Standardin11.5; Standardit111.2; Standardin111.4; StandardinIV.2

**<u>Vlerësimi i ekspertëve të GVJ:</u>** Nuk kemi përmendur asgjë negative në lidhje me Personelin Akademik, gjithashtu GVJ nuk ka vënë në dyshim asnjë nga meritat e tyre. GVJ në fakt ka qënë shumë i kursyer në këtë pikë, pasi GVJ ka theksuar se lëndët e profilit Infermieri duhet t'i japin vetëm Pedagogë që kanë mbaruar dhe Diplomuar në Infermieri, sa për sqarim kjo është në çdo program dhe Fakultet të Infermierisë në çdo vend të zhvilluar në botë dhe në vendin tonë. Përgjigja që GVJ mori nga Pedagogu i cili ishte i Diplomuar në Mjeksi, zhvillonte leksionet e lëndës së Infermieristikës ishte se, kishte përshtatur Leksionet për studentët e Infermierisë dhe kjo nuk është e rregullt. Bëhet fjalë për titull diploma dhe jo ndarje specialiteti pas diplomimit. GVJ ka përmendur vetëm lëndet të Infermieristikës dhe Jo lëndët Mjeksore. GVJ nuk ka vënë në diskutim mësimdhënien nga mjeku përsa i përket lëndës së tij, por vlen të theksohet që ashtu si një infermier nuk mund të japë psikiatri, pasi është jashtë kompetencave të tij, ashtu dhe një mjek nuk mundet dot të japë Infermieristikën e Psikiatrisë, pasi është jashtë kompetencave të tij.

**6. Standardi III. 4 / Kriteri 3, Standardi III.4 / Kriteri 5; 6; 7**

*Vlerësimi i ekspertëve të GVJ mendon se në këtë rast, pavarësisht vështirësive që mund të ketë hasur insitucioni, duhet të shtojë stafin e kualifikuar në fushën e infermierisë, për të shamngur mbulimin e lëndëve karakterizuese nga stafi jo i fushës. Këtu theksojmë që flasim për mbulimin e lëndëve karakterizuese, Infermieristikave.*

**Koment nga Universiteti:** Mbi kriterin 3, lutemi që GVJ të rishikoje vlerësimin e tij, pasi vërejmë se formulimi është një konstatim I përsëritur gjerësisht në Raport dhe në këtë rast nuk i përgjigjet kërkesave të kriterit 3 (shiko dhe pikën 1dhe 5 më lart).

Përsa i përket formulimit në kriterin 5, 6 dhe 7, sikurse përmendet nga Ekspertët është në fokus të Departamentit (Ref.Nr.4. Plani Strategjik I Zhvillimit të Programit të Studimit) në bashkëpunim me njësitë e tjera administrative në UET, që të mbështesë zhvillimin profesional të stafit akademik perms trajnimeve të vazhdueshme për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor.

Sigurisht për pjesën më të madhe të periudhës 2018-2021 të cilësi përket vlerësimi, e cila u ndikua nga situate e pandemisë së Covid-19, në focus kanë qenë trajnimet për mësimdhënien online.

Theksojme se UET ka qënë ndër të paktat institucione arsimore universitare në vend, i cili u përshtat në kohë record vetëm 1 javë nga fillimi i izolimit si pasojë epandemi së Covid-19 (bashkëlidhur Ref.Nr.4.1. lmazh nga trajnimi i dt.16.03.2020; Ref. Nr. 42. Trajnimet e vazhdueshme). Trajnimet nga Zyra e IT ne UET kanë qenë të vazhdueshme në këtë periudhë dhe sigurisht kanë patur efektin e tyre në ruajtjen e cilesisë së mësimdhëniesdhe aftësimin profesional të stafit me teknologjitë e mësimdhënies online (Ref.Nr. 46.4-46.5)- mund të përmendim se impakti I këtij reagim dhe rezultatet e trajnimeve u pane dhe në konkluzionet e nxjerra nga Fokus Grupet e zhvilluara në periudhën Janar 2022, ku studentë të Fakultetit të Shkencave Mjekesore Teknike vlerësuan reagimin e shpejtë të UET me situatën emergjentetë krijuar (Ref.Nr. 4.3. Ekstrakt fq.23_Raporti i Focus Grup). Aspekt tjetër i trajnimeve dhe mbështetjes së vazhdueshme të stafit akademik, janë mundësitë e shkëmbimit të eksperiencave me partnerë ndërkombetare, realizuar mendihmën e Zyrës se Projekteve nëUET (Ref.Nr. 43. Te dhena mbi projektet dhe shkembimin e stafit).

Nder trajnimet e tjera zhvilluar ne UET mbi mesimdheniendhe kerkimin shkencor permendim: Dhjetor2019: workshop "Mesimdhenia, Cilesia, Strukturimi"(Ref.Nr. 4.4) Qershor2021: workshop"InnovativeResearchandTeaching" (Ref.Nr.4.5-4.6)

**Vlerësimi i ekspertëve të GVJ:** Përsa i përket mbështetjes dhe zhvillimit profesional të stafit akademik përmes trajnimeve të vazhdueshme për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, që është detyrë e cdo Universiteti, GVJ se ka vënë në diskutim mbështetjen që UET i bën stafit akademik, gjë që është në të mirë të vetë Universitetit, gjithashtu dhe në lidhje me trajnimet nuk ka vënë në dikutim ato, pasi i ka marrë të mireqena, nevojë kjo dhe e stafit dhe e Universitetit. Por GVJ ka theksuar dhe është i mendimit që vetë institucioni duhet të shtojë numrin e trajnimeve "për fushën përkatëse", në mënyrë që ajo të zhvillohet, në kuadër të përmisrismit të mësimdhënies dhe punës kërkimore.

**7. Standardi III.1 / Kriteri 4, Standardi VI.5 / Kriteri 2**

*Vlerësimi i ekspertëve të GVJ: Sipas RVB-së, raportet e KSBC-së kanë të dhëna specifike personale, dhe diskutohen apo bëhen me dije vetëm personave apo grupeve që ky raport ka*

*ndikim të drejtëpër drejtë. Gjithsesi, GVJ mbështet idenë që duhet gjetur mënyra që këto raporte, duke ruajtur të gjitha parashikime ligjore në fuqi, të bëhen publike për të gjithë. GVJ sugjeron që KSBC-ja duhet të publikojë një përmbledhje, ose një version që nuk cënon të dhënat personale.*

**Koment ga Universiteti:** Kontrollet që realizohen nga KSBC dhe kanë të bëjnë me monitorimin e aktiviteteve të cilat garantojnë sigurimin e cilësisë perms vlerësimit të nivelit të përmbushjes së standardeve të përcaktuara në aktet rregullatore të Universitetit dhe vleresimin e efikasitetit të sistemit të brëndshëm të sigurisë, përmbyllen me raporte institucionale, ku për cdo njësi paraqiten gjetjet përkatëse. Gjetjet e përgjithshme dhe gjetjet respektive për cdo departament, janë drejtimet ku duhet të bazohet më tej puna e Departamentit të Universitetit për të nxitur praktikat e mira apo për të bërë përmirësime të nevojshme. Në këtë kuptim, lutemi të rishikohet shkalla e përmbushjes së Standardit111.1 dhe Vl.5 pasi sikurse është bërë e ditur gjatë fazave të procesit të akreditimit, raportet e vlerësimevetë KSBC dokumentohen dhe u bëhen tën johura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programet në kuadër të përmiresimit të tyre dhe praktikave që lidhen me aktivitete të stafit akademik, duke respektuar etiken akademike pasi edhe në kritere nuk specifikohet detyrim për publikimin në faqen ëeb. Lnformojme GVJ se në kuadër të transparencës dhe informimit të publikut, Universiteti publikon në ëebsite e tij raportete vleresimit të brendshem të departamenteve dhe raportete vleresimit të jashtëm të ekspertëve të vleresimit (https://uet.edu.al/raporte-vleresimi/). Gjithashtu, raportet vjetore të aktivitetit te UET i behen me dije Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

**Vlerësimi i ekspertëve të GVJ:** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, janë struktura hiearkike organizative (organet drejtuese dhe autoritete te UET) si dhe Komisioni i Brendshëm të Cilësisë që kujdeset, për hartimin, sigurimin, përditësimin dhe sigurimin e kuadrit rregullator të institucionit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Ajo monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat e personelit.

Këto raporte shpërndahen në të gjithë nivelet drejtuese por nga një kontroll i bërë faqes së UET nuk rezulton të publikohen online. GVJi qëndron mendimit që sugjeron, që në të ardhmen kjo të jetë e mundur

## 8. Standardi III.7 / Kriteri 5

*Vlerësimi i ekspertëve të GVJ: Nga shqyrtimi i kalednarit te aktivlteteve 2018 - 2021, GVJ veren se është zhvilluar vetëm nje leksion i hapur me temen "Psychologyofmotivation". GVJ është e idesë që për fushën e lnfermlerisë ka shumë tema interesante dhe novatore që rnund të diskutohen në leksionet e hapura, duke ftuar personalitet e të fushës, si brenda dhe jashtë lnstitucionit, duhet të shtoje perpjekjet për të rritur numrin e tyre."*

**Koment nga Universiteti:** Fakulteti i Shkencave MjekësoreTeknike, organizon cdo vit akademik jo vetëm leksione të hapura, ëorkshop, dhe forume me të ftuar që me ekspertizën e tyre i janë ofruar për diskutime/trajnime/prezantime jo vetëm auditorit të studentëve por edhe stafit akademik. Julutemi referojuni evidencave bashkangjitur (Ref. Nr. 8.1. Aktivitetet FSHMT_vitet akademike 2018-2019_2019-2020_2020-2021; Ref.Nr.8.2. Aktivitetet FSHMT 2021-2022). Evidenca që I referohen Ekspertet janë evente të zhvilluara në rang institucional. Lutemi të rishikohet vlerësimi për Standardin111.7, pasi pas këtyre plotesirneve të evidencave

(ASCAL: Lutemi referojuni dhe evidencave të DVV MSH Infermieri ku janë dhënë aktivitetet e FSHMT krahas atyre në nivel institucional) nuk hasim konstatime të tjera që të cënojnë përmbushjen e standardit.

**Vlerësimi i ekspertëve të GVJ:** GVJ këtu ka patur parasysh dhe konferenca dhe bashkëpunime me fakultete të njëjta brënda vendit dhe jashtë, për shkëmbim eksperiencash.

**Per sa me sipër, sqarimi i institucionit vlerësohet por nuk ndikon në ndryshimin e vlerësimit të standartit përkatës.**

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Infermieri"

### I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. | Institucioni ofron programin "Bachelor" në "Infermieri", me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të këtij programi studimi, gjithnjë në koherencë me kërkesat e tregut të punës, njohuritë inovative në fushën e studimit i përgjigjen interest kombëtar. Ky program studimi përshtatet me visionin e UET si dhe synon nxitjen dhe respektimin e vlerave kombëtare.<br>Ky program studimi mbështetet në studimet në fushën e Infermierisë, si dhe përmbushjen e objektivave strategjike institucionale, të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, dhe ekzaktësisht të Departamentit të Infermierisë. Në kurrikul pëfshihen lëndë të formimit të përgjithshëm, lëndë karakterizuese të programit, lëndë plotësuese si edhe lëndë ndërdisiplinore, me një total prej 180 kredite ECTS konform parashikimeve ligjore për programet e ciklit të parë të studimeve.<br><br>Aneks 3.3 Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit "Bachelor" në "Infermieri".<br>Aneks 2. Statuti UET Neni 6, pika 6.2 Ref nr. 2. |
| **Kriteri 2.** Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Program i studimit në Diplomën e Infermierisë, ruan vlerat akademike kulturore kombëtare. Në përgjithësi aktiviteti akademik dhe profesional i Departamentit të Infermierisë, mbështetet dhe përforcon vizionin e Universitetit Europian të Tiranës mbi ndërkombëtarizimin e vazhdueshëm të institucionit. Në funksion të këtij vizioni si edhe në vijim të arritjes të objektivave strategjikë të këtij programi studimi, Departamenti konsideron si prioritet progresiv t'u japë studentëve një edukim |

| | |
|---|---|
| | cilësor nëpërmjet mësimdhënies, perdorimit të arritjeve shkencore, si dhe partneriteteve me tregun e punës local dhe më gjërë, në atë ndërkombëtarë.<br><br>Aneks 3.3 Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit "Bachelor" në "Infermieri" Pika 6.<br>Aneks 2. Statuti UET Neni 6, pika 6.2 Ref nr. 2. |
| **Kriteri 3.** Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Ky program studimi mbështetet në strategjinë institucionale të Universitetit Europian të Tiranës të zbatuar konkretisht për studimet në fushën e Infermierisë, si dhe përmbushjen e objektivave strategjike institucionale, të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike. Rezultatet e studimit të tregut të punës dëshmojnë për rëndësinë e programit Bachelor në Infermieri, në funksion të përmbishjes së kriterit.<br><br>Aneks 3.3 Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit "Bachelor" në "Infermieri".<br>Aneks 7. Argumentimi për hapjen e programit. |
| **Kriteri 4.** Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. | Programet e studimeve janë të hartuara për të nxitur zhvillimin ekonomik. Në funksion të këtij vizioni si edhe në vijim të arritjes të objektivave strategjikë të këtij programi studimi, Departamenti konsideron si prioritet progresiv përmirësimin dhe forcimin e studentit, i cili pas përfundimit me sukses të ciklit të parë të studimit pajiset me diplomë universitare "Bachelor" në "Infermieri" dhe është i aftë të mbulojë një shërbim profesional të specializuar infermierorë, në kushte spitalore ose ambulatore dhe mund të punësohet në sektorë publik e privat, ku lind nevoja e menaxhimit dhe përdorimit të sistemeve të ndryshme bashkëkohore. Këto student kanë aftësinë të përshtaten më së miri edhe me teknologjitë inovative që i paraprijnë kohës.<br><br>Aneks 3.3 Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit "Bachelor" në "Infermieri".<br>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit - BA Infermieri. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.2**<br>**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni përcakton qartë se programet e studimit | UET, mbi bazën e licensimit dhe akreditimit, ofron programe te ciklit të parë të dytë dhe të tretë. Programet e studimit janë në |

| | |
|---|---|
| hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit. | përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.<br>Programi studimit mund të propozohet, hartohet dhe rishikohet me kërkesë të antarëve të departamentit dhe nga zyra e zhvillimit të kurrikulave dhe pastaj dërgohet per miratim më mbledhjen e Dekanatit e më pas në Senat, vetëm pasi të ketë marrë paraprakisht miratimin e Rektorit. Në dokumenta përshkruhet që program është konform objektivave strategjike për zhvillimin.<br><br>Aneks 4 Plani strategjik 2015-2020 (Ref NR.3). Neni 304.<br>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit - BA Infermieri. |
| **Kriteri 2.** Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit. | Studimet në UET, përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike. Në dokumente shprehet qartë fakti se UET, synon ruajtjen e profilizimit, në të gjitha ciklet e studimit, të cilat si rregull janë me kohë të plotë, të organizuara në module ose lëndë dhe të shprehura në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS), në frymën e Kartës së Bolonjës.<br>UET-i ofron programe në tri cikle studimi sikurse dhe programe studimi me karakter profesional. Çdo program studimi rregullohet me rregullore të veçantë të programit të studimit.<br><br>Aneks2. Statuti UET, neni 6, pika 6.3 (ref.nr.2), Neni 13 Forma e studimit Neni 16 Organizimi i programeve të studimit. |
| **Kriteri 3.** Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. | Programi i studimit Bachelor në "Infermieri", është emërtuar në përputhje me fushën dhe drejtimin akademik të institucionit. Kjo diplomë është një nga drejtimet e fushës së shkencave mjeksore teknike dhe është nën drejtimin e Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë. Në lidhje me lëndët, ata ndahen në lëndë me bazë karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, dhe kjo strukturë por edhe përmbajtja e bënë atë të jetë konform ligje në fuqi.<br><br>Aneks 4. Plani strategjik 2015-2020 (ref. Nr. 3).<br>Aneks 3.3. Plani Strategjik UET 2021, Objektivat Strategjike, pika 3.<br>Aneks2. Statuti UET,(Neni 6, pika 6.3), (ref. nr. 2).<br>VKM Nr.41 datë 24.01.2018 "Për element të programeve të studimit të ofruara nga IAL (ref. nr. 33). |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi I.3<br>**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit. | Programi i studimit në formimin e studentëve në diplomën e Infermierisë, ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve, këto objektiva, përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit. Objektivat formuese të këtij programi studimi përcaktohen ne Rregulloren e programit të studimit.<br>Formimi akademik dhe shkencorë i studentëve mbështetet që dhe përgatit studentë në fushën e infermierisë së përgjithshme duke filluar që nga njohuritë teorike bazë, me praktikën në qëndrat spitalore dhe shëndetësore publike dhe private, si dhe të përshtasë njohuritë teoriko-praktike dhe të sigurojë marrëdhënie të drejtëpërdrejta me kërkesat e tregut të punës.<br>Aneks 4. Plani strategjik 2015-2020 (ref. nr. 3. Neni 30).<br>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit - BA Infermieri. |
| **Kriteri 2.** Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. | Në përgjithësi aktiviteti akademik dhe profesional i Departamentit të Infermierisë mbështetet dhe përforcon vizionin e Universitetit Europian të Tiranës mbi nevojat e tregut të punës. Departamenti konsideron si prioritet progresiv evoluimin dhe forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar kryesisht me anë të nënshkrimit të marrëveshjeve konkrete bashkëpunuese. Prioriteti në fjalë përtej ndërkombëtarizimit, tenton e synon edhe përfshirjen e proceseve të tilla të ndërlidhura si: ofrimi i shkëmbimeve studentore dhe stafit akademik, punësimi i studentëve, mundësimi i realizimit të projekteve të ndryshme studimore, përditësimi i vazhdueshëm i kurrikulës së programit të studimit, si edhe publikimeve të punimeve shkencore e realizimin e konferencave të përbashkëta akademike.<br>Funksionimi i Bordit të tregut të punës, me profesionistë të fushës dhe alumni, garanton përputhshmërinë e përmbajtjes së programit dhe kërkesat e tregut të punës.<br>Aneks 12.1 Bordi i tregut të punës (ref. nr. 12.1).<br>Aneks 35. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.<br>Aneks 4. Plani strategjik 2015-2020 (ref. nr. Neni 301).<br>Aneks 29. Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve. |
| **Kriteri 3.** Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përftimin e dijeve, | Me qëllim arritjen e objektivave strategjikë, Departameti i Infermierisë dhe Fizioterapisë konsideron si prioritet, realizimin e procesit mësimor për përvetësimin cilësor të njohurive prej studentëve. Ndër prioritetet kryesore në këtë drejtim janë: struktura |

| | |
|---|---|
| aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. | dhe përmbajta e programit të studimit. Duke përfituar kështu njohuri teorike por dhe afëtsi praktike.<br>Programi ka një kurrikul bashkëkohore cilësore e aftë të ofrojë formimin e duhur akademik për pajisjen e studentëve me njohuri mbi fushën e studimeve në infermieri të përgjithshme si dhe rritjen e aftësive vendimmarrëse dhe profesionale.<br>Departamenti ka në focus përditësimi i vazhdueshëm me literaturën bashkëkohore si edhe përdorimi i metodave interaktive dhe audiovizuale të mësimdhënies, si dhe realizimi i orëve praktike me infrastukturën më të mirë spitalore, për të bërë të mundur përvetësimin e njohurive të marra gjate orëve mësimore<br>Bazuar në këto parametra GVJ mendon se programi i studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës.<br><br>Aneks 7.1. Rregullore Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor "Infermieri".<br>Aneks 12.1 Studimi për tregun e punës.<br>Aneks 14. Kurrikula e programit të studimit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.4**<br>**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar. | Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike përbëhet nga 3 njësi bazë, Departamenti i infermierisë dhe Fizioterapisë, Departamenti i Imazherisë dhe qëndra kërkimore në Shëndet Publik. Të tre këto njësi bazë i respektojnë parashikimet ligjore rreth nr të stafit akademik të angazhuar. Departamenti i Infermirisë dhe Fizioterapisë ka në përbërje të tij 8 PAE (3 Dr, 1 Dr. Proc., 4 Msc) dhe 3 PAK (1 Dr dhe 2 Msc). *Sidoqoftë, GVJ mendon se duhen shtuar personel akademik më shumë me gradë dhe tituj në fushën e Infermierisë si dhe të shtohen përpjekjet e institucionit me pasurimin e laboratorëve brënda institucionit, në funksion të praktikës së studentëve.*<br><br>Aneks 23 Të dhëna tabelore për personelin akademik të njësisë kryesore dhe njësisë përgjegjëse (ref.tabela 7)<br>Aneks 0.2. Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit (ref. teblat 12 dhe 6.1) |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Programi i studimit që ofrohet nga Deppartamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, ku konstatohet të jetë në përputhje me fushën e përgjithshme dhe specifike atë të departamentit. Gjithashtu departamenti është në përputhje si me pjesën akademik ashtu dhe me atë shkencore me Shkencave Mjekesore Teknike. Struktura e programit të studimit është në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kombëtare dhe ndërkombëtare. Lëndët janë ndarë në 5 kategori (A-E) si dhe përdoret sistemi ECTS, cka e bën më të lehtë edhe tranferimin apo lëvizjen e studentëve.<br>14.2. Plani mësimor i programit - BA Infermieri.pdf<br>Aneks 26. Të dhëna për numrin e programeve të ofruara nga njësia përgjegjëse.<br>Aneks 7.1. Rregullore mësimore e programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Infermieri". |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Programi i studimit që ofrohet nga Deppartamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, ku konstatohet të jetë në përputhje me fushën e përgjithshme dhe specifike atë të departamentit. Pjesë e veprimtarive mësimore në fushën përkatëse është edhe puna kërkimore. Gjatë vitit të parë të studimeve studenti ndjek lëndët Shkrim Akademik dhe Metodat e kërkimit, dhe aftësohet për të shtruar një tezë dhe për ta mbrojtur atë në formë analitike, duke u bazuar kryesisht në literaturën teorike. Këto aftësi studenti i zhvillon përgjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve, nëpërmjet përgatitjes së detyrave të kursit dhe detyrave praktike brenda secilës lëndë të programit.<br><br>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit - BA Infermieri.pdf<br>Aneks 7. Rregullore mësimore e programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Infermieri".<br>Aneks 26. Të dhëna Tabelore për numrin e programeve në ciklin e I-rë, të studimeve, që ofrohen në Njësinë përgjegjëse (Tabela 3). |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi I.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie | Shihet një bashkëpunim brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së |

| | |
|---|---|
| bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, cka e bën më të lehtë zbatimin e këtij programi studimi. Secila njësi apo component kontribon sipas specifikës së detyrës tij në mbarëvajtjen e programit të studimit. Këto janë të përcaktuara në aktet rregullatore qartë. Rolin kryesor e ka Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë.<br><br>Aneks 5. Rregullore e UET, Neni 16, 17, 18, 21, 22.<br>Aneks 2. Statuti UET.pdf<br>Aneks 6. Dokumenti F; IV; F; V, mbi organizimin e funksionimin e Dekanatit dhe Departamenti<br>Aneks 36. Vendim për emërimin e koordinatorëve të programeve të studimeve.<br>Aneks 38. Analiza e departamentit mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit. |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj. | Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve institucioni ka dokumente të cilat tregojnë për vendosjen e marrëdhënieve bashkëpunimi me institucionet brenda dhe jashtë vëndit. Mbi bazë të këtyre marveshjeve Institucioni bën të mundur zhvillimin e praktikave të studentëve ku vlen të theksohet marrëveshja me QSUT-në dhe Spitalin e Traumës nga insitucionet publike, pork a edhe shumë marrëveshje më private gjithashtu sic është Spitali Gjerman dhe ai Amerikan në Tiranë.<br>Institucioni realizon praktikat në marrëveshje me institucione homologe Brenda vendit, në institucione publike dhe private.<br><br>Aneks 34. Marrëveshjet e bashkëpunimit UET.pdf.<br>Aneks 34.3 Memorandum bashkepunimi UET QSUT.pdf<br>Aneks 34.6 Memorandum bashkepunimi UET Spitali Amerikan.pdf<br>Aneks 34.7 Memorandum bashkepunimi UET SUT.pdf |
| **Kriteri 3.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve. | Në funksion të mbarëvajtjes dhe arritjes së objektivave në ofrimin e programeve të studimit, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë në Fakultetin e Shkencave Mjeksësore Teknike, ka vënë në zbatim një sërë marrëveshjesh të nënshkruara në nivel institucional mes Universitetit Europian të Tiranës dhe institucioneve bashkëpunuese. Përfitimet e marrëveshjeve shtrihen në disa dimensione, qoftë në realizimin e praktikave profesionale qoftë në realizimin e mobiliteteve të stafit dhe studentëve, kryesisht me institucione homologe jashtë vendit. Por, marrëveshjet e nënshkruara me bashkëpunëtorët kanë rezultuar të rëndësishme edhe në aspketin e zhvillimit të trajnimeve profesionale dhe leksioneve të hapura me përfaqësues të këtyre institucioneve. |

| | |
|---|---|
| | Aneks 34. Marrëveshjet e bashkëpunimit UET.pdf.<br>Aneks 35. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit - DIF.pdf |
| **Kriteri 4.** Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë. | UET, përvec marrëveshjeve dhe përfitimet që ka nga ato për aspektet e praktikës, ka rregulluar këtë të fundit edhe me akte rregullatore të brëndshme, ku përfshihen të të gjithë elementet e nevojshëm për të kryer atë.<br>Praktitat ndiqen njëkohësisht nga një pëdago I brendshëm dhe nga personi i caktuar në isntitucionin pritës, ku student do të zhvilloje praktikën.<br><br>Aneks 14.Kurrikula e programit bachelor.<br>Dokument shtese Aneks 5.1. Formular Aplikimi per Praktiken Profesionale.pdf<br>Aneks 32.1. Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale.pdf |
| **Kriteri 5.** Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | UET përpiqet që nëpërmjet, aktiviteteve të ndryshme të ndihmojë sa më tepër studentët për zhvillimin e kompetencave të tyre profesionale. Në Universitetin Europian të Tiranës janë krijuar edhe funksionojnë disa klube studentore. Klubi i Mjekësisë "Hipokrati" mbledh rreth tij jo vetëm studentët e FSHMT, por edhe studentë të tjerë që kanë interes për shkencën mjekësore.<br><br>Aneks 33. Të dhëna për trajinmet profesionale. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

| **Standardi II.1**<br>**Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të | Programi i studimit është organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Europian të Tranferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) *edhe pse vihet re që në kurrikulën ekzistuese kreditet, kanë një mos përputhje me* |

| | |
|---|---|
| Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | *legjislacionin vendas në fuqi.* Zhvillimi i laboratorit kryhet brenda Universitetit, ku ka vetëm një laborator *cka GVJ mendon se duhen shtuar kapacitet laboratorike për studentët e këtij programi studimi.* Përsa i përket zhvillimit të praktikës klinike, ajo kryeht në institucione publike dhe private· me të cilët ka marrëveshje institucioni.<br><br>Aneks 14. Kurrikula e Programit Bachelor Infermieri<br>Aneks 32. Lista e studentëve dhe Institucioneve të zhvillimit të praktikës profesionale.<br>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit - BA Infermieri<br>B.I. Mbi praktikën profesionale (ref.nr. pika B.I.3.1 dhe B.I.9.) |
| **Kriteri 2.** Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh. | Ky program studimi është organizuar në atë mënyrë që studentët, përvec njohurive bazë në fushën e mjekësisë, të specializohen më thellë në profesionin e infermierit.<br>Programi i Studimit BA Infermieri ka mjaftueshëm orë studimi dhe ato ndahen si më poshtë: Leksione 643 orë , Seminare 336 orë, Laboratorë 0, Ushtrime 226.2 orë, Praktika/Detyra 448.2 orë, Praktikë profesionale 375 orë, Diploma/Provim Formimi 20 orë dhe në total kanë 2049 orë në auditor. Nga Institucioni na u vendos në dispozicion edhe një rregjistër ku ato shkruajnë dhe mbajnë temat e laboratorit. *GVJ mendon se pavarësisht metodave institucionale për mbajtjen e dokumentave, temat e laboratorit duhet të jenë të pasqyruara në syllabusin e cdo lëndë që i ka ato.*<br><br>Aneks 14. Kurrikula e programit Bachelor në Infermieri (tabela nr 13)<br>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit - BA Infermieri |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës. | Programi i studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimit të infermierisë, kjo e parë në syllabuset e lëndëve, si dhe në vlerësimin e studentëve. Këto njohuri ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe gërshetimi me njohuritë praktike I përkjonë fushës dhe parimeve akademike. Në vitin e parë të studimeve programi i studimit ofron kryesisht lëndët e formimit bazë (të kategorisë A) lëndët hyrëse të formimit karakterizues të programit të studimit (të kategorisë B) cka e ndihmon studentin të hyjë në këtë profesion dhe gradualisht në vitin e dytë dhe të tretë shtohen njohuritë specifike.<br><br>Aneks 7. Rregullorja e programit të studimit.<br>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit - BA Infermieri.<br>Aneks 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Infermieri (Aneks_Tabela 9). |
| **Kriteri 4.** Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, | Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike duke filluar që në vitin e parë, ku ka një sërë lëndësh të përgjithshme, ku merren një |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | sërë njohurish. Gjatë vitit të dytë dhe të tretë të studimeve, studenti thellon njohuritë dhe aftësitë në fushën e studimit, si edhe plotëson interesat e tij të veçanta studimore përmes profilit të zgjedhur prej tij. Përpara fillimit të çdo semestri të vitit të dytë dhe të tretë të studimeve, studenti bën regjistrimin e lëndëve që do të ndjekë, i konsultuar nga një pedagog i caktuar nga Departamenti. Gjatë dy viteve, vitit të 2 dhe të 3, zvillohen dhe praktikat klinike.<br><br>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit - BA Infermieri.<br>Aneks 14. 4. Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese |
| **Kriteri 5.** Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore. | Programi e studimit të ciklit të parë në infermieri, përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore. Në bazë të dokumentave ai është mbështetur në përputhje me kërkesat e IAL Nr. 80/2015, (neni 73). Programi ka 180 ECTS, me kohëzjatje normale, prej 3 vitesh Akademike. Mbyllet me provimin përfundimtar, si dhe në përfudnim, studenti pajiset me diplomë Bachelor në "Infermieri"<br><br>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit - BA Infermieri.<br>Aneks14.2. Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9)<br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Lëndët e programit të studimit janë të organizuar në kategori disiplinash dhe me kreditet përkatëse, ashtu sic e parashikon edhe ligji. Ngarkesa mesatare është 60 kredite në një vit, e ndarë në 30 kredite për semester, në total 180 ECTS. Sipas dokumentave që kemi në dispozicion, GVJ vuri re se Lendët bazë (A) nga 15-20% që parashikon ligji, programi i studimit ka 15.6 %. *Pavarësisht se është një lëvizje e vogël në përqindje, GVJ mendon se kjo duhet riparë në të ardhmen.*<br>Ngarkesa e secilit pedagog është e përshkruar për lëndët përkatëse. Ngarkesa vijon nga 260 orë deri në 195 në auditor.<br><br>Aneks 7. Rregullorja e programit të studimit, neni 3.3<br>Aneks 15. Modeli i Diplomës-Modeli i Suplementit<br>Aneks 14. Kurrikula e program bachelor në Infermieri<br>Ngarkesa totale e personelit akademik të programit BA Infermieri", v.a. 2020-2021 (Tabela 4)<br>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit - BA Infermieri.<br>Aneks14.2. Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9) |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

**Standardi II.2**

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. | Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Njësia kryesore është Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, i cili ka në përbërjen e tij të paktën 3 njësi bazë sic janë Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Departamenti Imazherisë dhe Qëndra e Kërkimeve në Shëndet Publik. Programi i studimit i përket Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë, i cili ka në përbërjen e tij 7 PAE dhe 8 PAK. Si fakulteti ashtu edhe departamenti, përmbushin kriteret ligjore në fuqi për përbërjen e tyre.<br>Në këtë program studimi janë përfshirë si staf akademik ashtu edhe ndihmës Akademik. Njësia bazë, observon dhe monitoron kontorollin në drejtim të cilësisë dhe mbarvajtjen e programi të studimit.<br><br>Aneks 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit<br>Aneks 6. Dokumenti F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit, pika F.V.2 [3] |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse. | Me vendim Dekanati, nr.86, datë 21.12.2021, Prof. Dr. Pirro Prifti emmërohet coordinator I programeve të studimit Bachelor në "Infermieri" dhe Bachelor në "Imazheri". Në këtë vendim parashikohen edhe detyra te koordinatorit i cili ka një sërë detyrash, duke filluar nga hartimi i programeve të studimit e deri në ndjekjen e ecurisë së praktikave. Cdo vit ai harton një raport mbi arritjen e objektiva, të cilin ja paraqet titullarit.<br><br>Aneks 36. Vendimi i emërimit të koordinatorit të programit<br>Aneks 6. Dokumemti F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit, pika F.V.2 |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit I plotëson kërkesat ligjore rreth përbërjes dhe organizimit së strukturës akademike. Departamenti të Infermierisë dhe Fizioterapisë, ka në përbërjen e tij 7 PAE (1 Prof. Dr., 1 Prof. As.,1 Dr, 4 Msc) dhe 8 PAK (2 Dr, 6 Msc). Kjo për vitin akademik 2020-2021, vit që edhe instritucioni ka aplikuar për akreditim. Departamenti organizohet në grup-lëndë, ku grupohen anëtarët e departamentit që kanë fusha të përafërta. Referuar RVB-së, pedagogët me grada dhe tituj angazhohen më tepër në vitin e dytë dhe të tretë të programit të studimit. |
| **Kriteri 4.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. | |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| | Aneks 6. Dokumemti F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit, pika F.V.3<br>Aneks 0.2. Tabelat përmbledhëse – tabela 1<br>Aneks 23. Personeli Akademik i njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse ( Tabela 1 dhe 2) |
| **Kriteri 5.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | Ashtu sic jemi shprehur edhe më lartë, GVJ mendon se ky kriter plotësohet. Departamenti të Infermierisë dhe Fizioterapisë, ka në përbërjen e tij 7 PAE (1 Prof. Dr., 1 Prof. As.,1 Dr, 4 Msc) dhe 8 PAK (2 Dr, 6 Msc).<br><br>Aneks 6. Dokumemti F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit, pika F.V.3<br>Aneks 0.2. Tabelat përmbledhëse – tabela 1<br>Aneks 23. Personeli Akademik i njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse ( Tabela 1 dhe 2) |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.3**<br>**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuara dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | Departamenti ka askes të plotë në cdo informacion dhe dokument, duke filluar nga Statuti dhe Rregullorja e programit të studimit, por edhe në planet mësimore, syllabuset, etj, të cilat janë edhe përgjegjësi e tyre për ti plotësuar. Departamenti I Infermierisë dhe Fiozterapisë, është përgjegjëse për këtë program studimi dhe ka njohuri të plota rreth tij. Kjo gjë vihet re nga takimi që zhvilluam si me drejtuesin ashtu edhe nga stafi akademik. Shumica e informacionit është edhe në faqen e internetit ëëë.uet.edu.al.<br><br>Aneks 6. Dokumemti F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit, pika F.V.3<br>Aneks 23. Personeli Akademik i njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse ( Tabela 1 dhe 2)<br>Vizita në insitucion |
| **Kriteri 2.** Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. | Programi ofrohet prej Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapise (DPIF), pjesë e (FSHMT). Në kurrikulë pëfshihen lëndë të formimit të përgjithshëm, lëndë karakterizuese të programit, lëndë plotësuese si edhe lëndë ndërdisiplinore/, me një total prej 180 kredite ECTS konform parashikimeve ligjore për programet e ciklit të parë të studimeve. Ky program studimi |

| | |
|---|---|
| | mbështetet në strategjinë institucionale të Universitetit Europian të Tiranës të zbatuar konkretisht për studimet në fushën e Infermierisë, si dhe përmbushjen e objektivave strategjike institucionale, të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, dhe ekzaktësisht të Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë<br>Programi i studimit është i detajaur në dukementin e planit mësimor dhe syllabuset përkatës, *edhe pse GVJ është e mendimit se orët laboratorike duhet të përfshihen në rregjistër si dhe te respektohet ndarja në % e kategorive.*<br><br>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit bachelor në infermieri<br>Aneks14.2. Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9)<br>Aneks14.1 Kurrikula e Programi Bachelor në "Infermieri" Lëndë/Module |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra. | Programet e studimit duhet të organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra. Programet e lëndëve (syllabuset) hartohen sipas formatit të miratuar, konsultohen nga përgjegjësi i grupit mësimor dhe miratohen nga Drejtuesi i Departamentit përkatës.<br>Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit ka një mospërputhje të krediteve për cdo vit akademik. Ata janë përkatësisht 61 ECTS vitin e parë, 58 ECTS vitin e dytë dhe 61 ECTS vitin e tretë.<br><br>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit bachelor në infermieri<br>Aneks14.2. Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9)<br>Aneks14.1 Kurrikula e Programi Bachelor në "Infermieri" Lëndë/Module |
| **Kriteri 4.** Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. | Kreditet e çdo lënde mbajnë parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Lëndët e thjeshta kanë 4 - 6 kredite, ndërsa ato të përbëra nga module kanë 10 - 12 kredite. Një kredit është 25 orë mësimore pune e studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda lëndës) dhe orë për punë të pavarur të studentit.<br><br>Kreditet e një disipline fitohen vetëm pas vlerësimit të studentit me notë kaluese. Në rastin e disiplinave të përbëra nga 2 module, studenti vlerësohet me notë përfundimtare dhe fiton kreditet përkatëse pasi të ketë marrë jo më pak se 41 pikë në secilin nga modulet. Nëse pikët e nevojshme janë marrë në njërin nga |

| | |
|---|---|
| | modulet, kreditet e atij moduli llogariten vetëm për efekt të kalimit të studentit në vitin pasardhës të studimeve.<br><br>Një ndarje më e detajuar është si më poshtë:<br>- Leksionet 11 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur e studentit<br>- Seminaret 7 orë në auditor dhe 18 orë punë e pavarur e studentit /ose 8 orë në auditor dhe 17 orë punë e pavarur e studentit<br>- Laboratorë / Ushtrime 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit<br>- Projekt/detyra: 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit /18 orë në auditor dhe 7 orë punë e pavarur e studentit<br>- Praktikën Profesionale 100 orë në auditor dhe 25 orë punë e pavarur e studentit<br>- Punim diplome/provim i përgjithshëm përfundimtar: 20 orë në auditor dhe 155 orë punë e pavarur e studentit.<br>Në total një student kryen 2049 orë në auditor:<br>- Leksione 643 or;<br>- Seminare 336 orë;<br>- Laboratorë /Ushtrime 226.2 orë;<br>- Praktika/Detyra 448.2 orë;<br>- Praktikë profesionale 375 orë;<br>- Diploma/Provim Formimi 20 orë.<br><br>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit bachelor në infermieri<br>Aneks14.2. Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9)<br>Aneks14.1 Kurrikula e Programi Bachelor në "Infermieri" Lëndë/Module<br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri (shqip) |
| **Kriteri 5.** Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Programet e studimit përmbajnë kanë të pasqyrurara informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të si për kritetret e pranimit të studentëve ashtu dhe për kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Për t'u pranuar në këtë program studimi kandidati/studenti duhet të ketë përfunduar me sukses provimet e detyrueshme të Maturës Shtetërore, plotësojnë kriterin e notës mesatare, sipas legjislacionit në fuqi dhe të zotërojë një diplomë të shkollës së mesme të përgjithshme me kohëzgjatje tre vjet ose sipas sistemit të vjetër me kohëzgjatje katër vjet, ose dhe shkollë të mesme profesionale. |

| | |
|---|---|
| | Kandidati mund të ketë edhe diplomë të lëshuar nga një institucion jashtë vendit, e cila duhet të njihet nga Ministria përgjegjëse për arsimin, në përputhje me legjislacionin në fuqi.<br><br>Në këtë program studimi pranohen edhe kandidatë/studentë të cilët kanë një diplomë universitare të marrë në një institucion të arsimit të lartë brenda ose jashtë vendit dhe kërkojnë të ndjekin një program të dytë studimi. Në rastet kur studenti kërkon njohje të krediteve, procesi i njohjes dhe vlerësimit të programit të studimit bëhet nga Departamenti përgjegjës për programin ku studenti kërkon të regjistrohet.<br><br>Në këtë program studimi mund të transferohen studentë nga programe të tjera të studimit të ciklit të parë, në fushë të njëjtë ose të përafërt, vetëm në fillim të vitit akademik.<br><br>Studenti ka të drejtë të transferojë vetëm lëndë të vlerësuara me notë përfundimtare kaluese. Në rast njohjeje studenti bart notën me të cilën është vlerësuar në programin e mëparshëm të studimit. Nga kjo klauzolë përjashtohen studentët që transferojnë studimet brenda UET-it, të cilëve u njihet e drejta e riprovimit për lëndët në provimin e të cilave nuk janë paraqitur ose kur janë vlerësuar me notë jokaluese.<br><br>Studenti regjistrohet në vitin e dytë nëse i janë njohur jo më pak se 30 kredite, dhe në vitin e tretë nëse i janë njohur jo më pak se 60 kredite.<br><br>Në çdo rast studenti duhet të ndjekë në UET së paku një vit akademik. Studenti duhet të fitojë përmes programit të UET jo më pak se 25% të ECTS-ve në kategoritë e lëndëve A-D, si dhe të përmbushë detyrimet përmbyllëse (Kategoria E) të programit të studimit. Procesi i vlerësimit të kurrikulës dhe njohjes së lëndëve bëhet nga Komisioni i Njohjes i departamentit.<br><br>Aneks 7. Rregullorja e programit të studimit, pika 2 dhe 9.<br>Aneks 28. Dokumenti II, mbi transferimet njohjen ekrediteve dhe mobilitetin e studenteve |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë | Në sillabuset e paraqitura, programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për lëndore (syllabuset janë të detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. *Ajo që u vu re nga GVJ dhe sic jemi shprehur edhe* |

| | |
|---|---|
| auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | *më lartë, në syllabus nuk paraqiten në temat e praktikës që bën studenti në praktikën klinike.*<br><br>Aneks 19. Modeli i syllabuseve, elementet sipas VKM 41/2018, e ndryshuar, (Tabela 14)<br>Aneks 39. Dokumenti A III. Mbi parimet e ndërtimit të lëndës dhe përdorimit të literaturës |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.<br>Programi i studimit, plani mësimor, lëndët dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program, si dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike, ashtu sic parashikohet në rregulloren e programit të studimit. Ndryshimet propozohen nga Departamenti, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave, por edhe nga anëtarë të personelit akademik, në konsultim me Bordet e Tregut të Punës, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme.<br><br>Propozimi për ndryshime në çdo rast vjen i argumentuar nga pala e interesuar. Ai shqyrtohet në Departament dhe nga Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave dhe pastaj dërgohet për miratim në mbledhjen e Dekanatit. Si rregull, rishikimi mund të bëhet vetëm para fillimit të vitit akademik dhe jo në mes të vitit akademik apo pasi ai të ketë filluar. Rishikimi i programit mund të parashikojë bashkime lëndësh ose ndarje të tyre, por pa cenuar raportet e përcaktuara për secilën kategori disiplinash në program, rishikimin e krediteve të lëndëve, të teksteve që do të përdoren por edhe të literaturës.<br>Në çdo rast, ndryshimet nuk mund të jenë të tilla që të devijojnë nga formimi i kërkuar për fushën përkatëse të studimit.<br><br>Aneks 10. Rregullorja e programit të studimit |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. | Lëndët e thjeshta kanë 4 - 6 kredite, ndërsa ato të përbëra nga module kanë 10 - 12 kredite. Një kredit është 25 orë mësimore pune e studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda lëndës) dhe orë për punë të pavarur të studentit. Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit për:<br>- Leksionet 11 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur e studentit<br>- Seminaret 7 orë në auditor dhe 18 orë punë e pavarur e studentit /ose 8 orë në auditor dhe 17 orë punë e pavarur e studentit<br>- Laboratorë / Ushtrime 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit<br>- Projekt/detyra: 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit /18 orë në auditor dhe 7 orë punë e pavarur e studentit<br>- Praktikën Profesionale 100 orë në auditor dhe 25 orë punë e pavarur e studentit<br>- Punim diplome/provim i përgjithshëm përfundimtar: 20 orë në auditor dhe 155 orë punë e pavarur e studentit.<br>Në total një student kryen 2049 orë në auditor:<br>- Leksione 643 or;<br>- Seminare 336 orë;<br>- Laboratorë /Ushtrime 226.2 orë;<br>- Praktika/Detyra 448.2 orë;<br>- Praktikë profesionale 375 orë;<br>- Diploma/Provim Formimi 20 orë.<br>-<br>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit bachelor në infermieri<br>Aneks14.2. Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9)<br>Aneks14.1 Kurrikula e Programi Bachelor në "Infermieri" Lëndë/Module<br>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit të studimit<br>Aneks Tabelat përmbledhëse – tabela 13 "Ngarkesa totale në auditor e studentëve, për format të mësimdhënies në programin e studimit"<br>Aneks14. Ngarkesa totale në auditor e studentëve për Format e mësimdhënies në programin e studimit, për secilin program (Tabela 13) |
| **Kriteri 2.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve. | Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave evidentohen në ngarkesën mësimore, ato i mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve. Studentët arrijnë të marrin si njohuritë e duhura teorike ashtu edhe ato praktika, të nevosjhme për tu punësuar në profesionin e infermierit, sin ë institucione publike ashtu edhe private. |

| | |
|---|---|
| | Aneks 14.2. Plani mësimor i programit bachelor në infermieri<br>Aneks14.2. Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9)<br>Aneks14.1 Kurrikula e Programi Bachelor në "Infermieri" Lëndë/Module<br>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit të studimit<br>Aneks Tabelat përmbledhëse – tabela 13 "Ngarkesa totale në auditor e studentëve, për format të mësimdhënies në programin e studimit"<br>Aneks14. Ngarkesa totale në auditor e studentëve për Format e mësimdhënies në programin e studimit, për secilin program (Tabela 13) |
| **Kriteri 3.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional. | Gjatë një viti akademik organizimi i veprimtarisë dhe ngarkesës mësimore, shtrihet në 2 semestra me kohëzgjatje secili semester 14 javë. Lëndët e programit zhvillohen sipas Tipologjisë I ose II. Në vitin e parë të studimeve programi i studimit ofron kryesisht lëndët e formimit bazë (të kategorisë A), lëndë plotësuese (të kategorisë D), si dhe lëndët hyrëse të formimit karakterizues të programit të studimit (të kategorisë B). Të gjitha lëndët e ofruara janë të detyrueshme. Gjatë vitit të dytë dhe të tretë të studimeve, studenti thellon njohuritë dhe aftësitë në fushën e studimit, si edhe plotëson interesat e tij të veçanta studimore përmes profilit të zgjedhur prej tij (kategoria C).<br><br>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit bachelor në infermieri<br>Aneks14.2. Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9)<br>Aneks14.1 Kurrikula e Programi Bachelor në "Infermieri" Lëndë/Module<br>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit të studimit<br>Aneks 10.1-10.4. Kalendari akademik viti akademik 2018-2019;2019-2020;2020-2021;2021-2022 |
| **Kriteri 4.** Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | Programet e lëndëve (syllabuset) hartohen sipas formatit të miratuar, konsultohen nga përgjegjësi i grupit mësimor dhe miratohen nga Drejtuesi i Departamentit përkatës.<br>Në fillim të çdo semestri studentëve iu vihen në dispozicion programet dhe materialet për çdo lëndë që ofrohet. Pedagogu i lëndës vendos në sistemin LMS, syllabusin së bashku me leksionet, literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar të lëndës. Përmes këtij sistemi studentët njoftohen për detyrat që pedagogu cakton, si edhe informohen për rezultatet e vlerësimit.<br><br>*Vihet re që shpërndarja është më shumë orë teorike dhe jo e balancuar me orët praktike, gjë që con në mos arrtjen e objektivave dhe aftësimit professional.*<br><br>Aneks 19. Syllabuset e lëndëve<br>Aneks 7, Ref. 31.4-3.1.5. Rregullore mësismore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor<br>Aneks 14. Kurrikula e programit BA në Infermieri<br>Anesks 14.2. Plani mësomor I programit BA Infermieri. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Në kurrikul është bërë ndarja sipas veprimtarive formuese dhe por nuk kemi një ruajtje të raporteve midis formimit teorik dhe praktik, e cila ndikon në maksimalizimin e arritjeve dhe objektivave formues. Në rregullore përshkruhet mënyra e tranferimit të të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Gjithashtu gjejmë të detajuar, në planin mësimor të ndarë sipas veprimtarive formuese.<br><br>Ndarja e programit të studimit sipas kategorive ndihmon në përthithjen nga studenti të njohurive, por edhe ndihmon në transferime edhe mobilitete që cdo student ka mundësi ti bëjë.<br><br>Aneks 14. Kurrikula e Programit BA në Infermieri<br>Aneks 7. Rregullore e Programit të BA infermieri, neni 16, pika 16.2 (Ref. nr. 5)<br>Aneks 14. 4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese, BA Infermieri. |
| **Kriteri 6.** Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. | Programet e lëndëve/moduleve duhet të përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. Literatura bazë mbështetej në leksione të pregatitura nga pedagogu kryesisht, por kishte dhe lendë që literaturën bazë e kishin në gjuhë të huaj.<br>Nga vizita, stafi u shpreh që kanë mundësi që të kërkojnë tituj të rinj për të pasuruar bibliotekën si dhe në të ardhmen, universiteti ka premtuar që do të publikojë libra me shtëpinë botuese që ka.<br><br>Aneks 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë. | Përmbajtja e programit në përmbajtjen e tij, synon të ndihmojë studentët në përfitimin e dijeve, të cilat kanë si qëllim arritjen e aftësisive dhe kompetencave, të cilat përputhen me njohuritë që një student I ciklit të parë mund të përfitojë. Orët e prkatikës, I shtojnë edhe ëm shumë mundësi stdudentit që mabron këtë program studimi, që të punësohet në tregun e punës.<br><br>Aneks 14. Kurrikula e Programit BA në Infermieri<br>Aneks 7. Rregullore e Programit të BA infermieri, neni 16, pika 16.2 (Ref. nr. 5)<br>Aneks 14. 4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese, BA Infermieri. |
| **Kriteri 8.** Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve, pas ciklit të parë, si dhe koordinimi me praktikën sipas vitetve bën të mundur edhe angazhimin e tyre në profesion. *Por vlen të theksohet fakti që në ambjentee Fakultetit ka vetëm një laborator, për studentët. GVJ e konsideron këtë hapsirë si jo mjaftueshëm për të kryer praktikën lëndore.* |

| | |
|---|---|
| | *Po ashtu dhe praktika klinike që bëhet në Qënrat Shëndetësore Parësore, Dytësore dhe Terciare nuk i përmbush numrin e nevojshëm të orëve për studentët. Përmbushja me saktësi e këtij kriteri do të mundësonte punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.*<br><br>Aneks 7. Rregullore e Programit të BA infermieri, neni 16, pika 16.2 (Ref. nr. 5)<br>Aneks 14. 4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese, BA Infermieri.<br>Aneks 19. Syllabuset e lëndëve |
| **Kriteri 9.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.<br><br>Aneks 12.1. Bordi i tregut të punës |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi II.5**<br>**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. | Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, mbulon ngarkesën mësimore duke qënë kështu i angazhuar për realizimin e programit të studimit. *GVJ ka evidentuar lëndë të profesionit që nuk jepen nga pedagogë të diplomuar në fushën e Infermierisë, ku si përgjigje morëm se këto lëndë janë përshtatur nga pedagogu me leksionet për displinën, gjë që nuk përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Pedagogët kanë detyrimin primar të të jenë të diplomuar në diplomën përkatëse, pasi cdo pershtatje e leksioneve nuk do të ishte efikase për studentët.*<br><br>23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit (Aneks_Tabela 1dhe 2)<br>0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - BA Infermieri<br>CV e stafit akademik |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të | Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit në përgjithësi |

| | |
|---|---|
| kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.<br><br>**Kriteri 3.** Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. | kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, por *GVJ ka evidentuar lëndë të profesionit që nuk jepen nga pedagogë të diplomuar në fushën e Infermierisë.* Për vitin akademik 2020-2021, stafi përgjegjës për këtë program studimi ndahet në 17 Staf akademik efektiv (PAE) me 2 Prof. Dr,1 Prof. Asc., 8 Dr , 6 Msc dhe 5 Staf akademik me kontratë (PAK) me 2 Dr dhe 3 Msc. Ngareksa më e madhe ë programit të studimit mbulohet nga stafi akademik efektiv, ashtu sic e kërkon edhe ligji.<br><br>Përsa i përket nivelit të kualifikimit dhe fushës Akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, ka personel në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij, *por GVJ mendon se është e nevojshme shtimi i personelit akademik të cilët janë të diplomuar në këtë fushë.*<br><br>23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit (Aneks_Tabela 1dhe 2)<br>0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - BA Infermieri<br>Aneks 11. Dokumenti G.II. mbi parimet e shpërndarjes së ngarkesës mësimore<br>Aneks 23. Të dhëna për personelin akademik të programit (Tabelat 12 dhe 6. |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | UET ka hartuar strategjinë e ndërkombëtarizimit në nivel institucional duke përfshirë edhe programet e studimit për FSHMT. Gjithashtu, lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare zhvillohet në kuadër institucional. UET ka marrëveshje bashkëpunimi me 15 IAL shqiptare, publike dhe jo publike. Një ndër këto programe është edhe Erasmus+, i cili u lejon lëvizshmërinë studentëve dhe stafit akademik, në Universitete të tjera jashtë vendit, për të shkëmbyer eksperiencat e tyre.<br><br>Në ditën e viziztës, nga diskutimet e bëra, *GVJ është e idesë së orët praktike kanë mangësi në zhvillimin e tyre*. Gjithashtu, përsa i përket praktikës profesionale ajo ndiqet nga një As. Lektor i brendshëm dhe nga mbikqyrsit i insitucionit ku shkon student, ku në fund dorëzohet dhe mbrohet një raport nga studenti.<br><br>Aneks 35. Raporti I perfitimit te nga marreveshjet e bashkepunimit<br>Aneks 19.Syllabus_Praktike Klinike II.pdf<br>Aneks 19.Syllabus_Praktike klinike I.pdf<br>Aneks 19.Syllabus_Praktike klinike III.pdf<br>Aneks 32.1. Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale.pdf<br>Aneks 32.2. B-I-4 Formulari i vetvlersimit të praktikës (nga Studenti).<br>Evidence shtese 5.3. Formular i Vleresimit te Studentit Praktikant.pdf |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të | Për realizimin e orëve të laboratorit, Insitucioni ka vetëm një laborator edhe pse numri i studentëve të rregjistruar për herë të |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | parë për vitin akadmeik 20202-2021 është 73. Gjithashtu ka vetëm një staf akademik që ndjek atë. *GVJ është e idesë që duhen shtuar përpjekjet për pasurimin e institucionit me laboratore dhe staf të nevojshëm për udhëheqjen e orëve laboratorike.*<br><br>0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - BA Infermieri<br>Aneks 11. Dokumenti G.II. mbi parimet e shpërndarjes së ngarkesës mësimore<br>Vizita në ambjentet e Institucionit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

**Standardi III.1**
**Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve. | Institucioni ndjek nje politikë të qartë si dhe harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.<br>Në vitin e parë të studimeve programi i studimit ofron kryesisht lëndët e formimit bazë. Të gjitha lëndët e ofruara janë të detyrueshme. Gjatë vitit të dytë dhe të tretë të studimeve, studenti duhet të thellon njohuritë dhe aftësitë në fushën e studimit, Gjithashtu Institucioni ka hartura dhe detyrat e tutoriatit akademik, si duhet të plotësojë interesat të veçanta studimore të studentit përmes profilit të zgjedhur.<br><br>Aneks 27.2. Mbi tutoriatin e keshillimit akademikte fakultetit<br>Aneks 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative | Strukturat përgjegjëse, Departamenti që është njësia bazë e zhvillimit të mësimdhënies zhvillon mekanizma të monitorimit për vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive të mësimdhënies të personelit akademik. Departamenti organizohet në grupe |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| të personelit akademik dhe ndihmës akademik. | mësimore, ku grupohen anëtarët e Departamentit që kontribuojnë në lëndët e përafërta, të cilat drejtohen nga Përgjegjësit e grupeve mësimore. Mbledhjet e zakonshme të Departamentit zhvillohen në një ditë të caktuar të javës. Një mbledhje në muaj duhet të jetë e hapur për studentët e programeve që administrohen nga Departamenti gjithashtu ai nxit, programon dhe bashkrëndon veprimtarinë e mësimdhënies.<br><br>Aneks 6. Dokumenti F.IV-F.V. mbi organizimin dhe funksionimin e dakanatit dhe departamentit<br>Aneks 15.2. Statuti i UET (Ref nr 15.2) |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | Studentët përfshihen n vlerësimin peridodik të stafit akademik, jo vetëm në aspektin professional por edhe në atë të komunikimit, sjelljes, mëbshtetjes në mësim etj. Format më të përdorura janë focus grupet dhe pyetsorët semestral, që studentët i plotësojnë përpara hyrjes në provim. Gjithashtu studentët janë të lirë të shprehen edhe në diskutimet ehapura të departamentit, ku mund të ankohen për cdo shqetsim që kanë, si për stafin ashtu edhe për vetë insittucionin. Studentët mund të shprehen edhe tek koordinatori i programi të studimit që mund ti adresojë ato problematika në instancat përkatëse.<br><br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 5. Rregullore e UET.<br>Aneks 40.1. D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve.<br>Aneks 36. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit - BA Infermieri. |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, janë struktura hiearkike organizative (organet drejtuese dhe autoritete te UET) si dhe Komisioni i Brendshëm I cilësisë që kujdeset, për hartimin, sigurimin, përditësimin dhe sigurimin e kuadrit rregullator të institucionit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Ajo monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat e personelit. Këto raporte shpërndahen në të gjithë nivelet drejtuese *por nga një kontroll i bërë faqes së UET nuk rezulton të publikohen online. GVJ sugjeron që në të ardhmen kjo të jetë e mundur.*<br><br>Aneks 30.3 Strategjia per sigurimin e brendshem te cilesise.<br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 30.5 Metodologjia e punes se KSBC provimet. |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik | Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies. Titullarët e isnitucionit pasi vihen në |

| | |
|---|---|
| për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies. | dijeni me gjetjet nga mekanizmat e vlerësimit, marrin masa për këshillimin e stafit, aty ku ka nevojë. Qëllimi i insitucionit është që të marrë masa për përmirsimin dhe garantimin e cilësisë. Prioritetet në procesin mësimor përcaktuar në strategjinë për zhvillimin e programit të studimit janë vënia në zbatim arrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione partnere dhe institucione shëndetësore publike dhe private, azhornimin dhe rritjen e cilësisë së vazhdueshme së kurrikulës së këtij program studimi, realizimin dhe ndjekjen praktikës profesionale infermierore me mbikqyrjen e stafit akademik dhe atij spitalor sipas pavioneve, etj.<br><br>Aneks 4. Plani Strategjik per Zhvillimin Programit të Studimit "Bachelor"në "Infermieri"<br>Aneks 30.3 Strategjia per sigurimin e brendshem te cilesise.<br>Aneks 2. Statuti UET. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike. Për realizimin e praktikave janë lidhur një sërë marrëveshje bashkëpunimi. *Edhe pse GVJ mendon se në insitucion duhen shtuar kapacitetet për laboratore, duke qenë se 1 laborator nuk është mjaftueshëm për numrin e lartë të studnetëve.*<br><br>Gjithashtu, në vizitën në institucion, në lidhje me pyetjen se si janë të pregatitura leksionet, GVJ mori përgjigjen se lëndë të disiplinës, ishin përshtatur nga Pedagogë të cilët nuk kishin formimin e kësaj disipline. *GVJ mendon se është e nevojshme rekrutimi i menjëhershëm i stafit të kualifikuar në fushën e infemierisë.* Nës disa raste, ka edhe lëndë të cilat kanë leksione në gjuhë të huaj.<br><br>Aneks 14. Kurrikula e Programit BA në Infermieri<br>Aneks 7. Rregullore e Programit të BA infermieri, neni 16, pika 16.2 (Ref. nr. 5)<br>Aneks 14. 4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese, BA Infermieri.<br>Vizita ne institucion<br>Syllabuset e lëndëve |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2**. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. | Në dokumentin *Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit te Studimit "Bachelor" ne "Infermieri"*, ku citoj "*Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.*", GVJ mendon se UET dhe stafi akademik ka marrë masat e duhura për të respektuar vecantinë e cdo student. Studentët kanë mundësi që të ndiqen edhe nga një tutor, i cili ka për detyrë të jetë i komunikueshëm dhe këshillues me studentin. Kjo u verifikua edhe nga diskutimet me studentët dhe stafin akademik gjatë vizitës në insitucion.<br><br>Aneks 11.4. Plani Sttrategjik per Zhvillimin e Programit te Studimit "Bachelor" NË "Infermieri"<br>Ankes 27.2 Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.pdf |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. | Në dokumentin e Planit Strategjik per Zhvillimin e Programit te Studimit "Bachelor" ne "Infermieri", Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapise konsideron prioritet gjithashtu mbështetjen e stafit akademik të programit të studimit në trajnimin e vazhdueshëm të tyre me qëllim rritjen e cilësisë akademiko-profesionale.<br><br>Fokus të rëndësishëm në prioritetet për trajnimin e vazhdueshëm të stafit akademik të programit, kanë shkëmbimet e përvojave akademike me institucione të arsimit të lartë dhe institucione kërkimore-shkencore partnere vendase dhe të huaja.<br><br>Aneks 11.4. Plani Sttrategjik per Zhvillimin e Programit te Studimit "Bachelor" në "Infermieri"<br>Aneks 43. Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit.pdf<br>Aneks 35. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit - DIF.pdf<br>Aneks 33. Të dhëna për trajnimet profesionale.pdf |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. | Përsa i përket Personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie, GVJ mendon se pavarësisht se vlerëson punën dhe eksperiencën e secilit professor, në vizitën që u bë në institucion *GVJ u informua se ka disa lëndë të profilit që janë të përshatura dhe nuk jepen nga staf akademik të profilit. GVJ është e mendimit që duhen shtuar përpjekjet për pasurimin e stafit akademik të specializuar në fushën e infermierisë.* Përsa i përket metodave të mësimdhënies, stafi akdemik përdor leksione, ese, detyra, praktika, metoda fleksibël që e bëjnë studentin të përfitojë më mirë programin e studimit.<br><br>Aneks 14. 4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese, BA Infermieri. |

| | |
|---|---|
| | 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - BA Infermieri<br>CV e stafit akademik<br>Vizita ne institucion |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Sic është evidentuar edhe më lartë, studentët nëprmjet fokus grupeve, pyetsorëve semestral, këshillimin nga Tutori dhe Koordinatori i programit të studimit, etj, ato gjithashtu pyeten edhe nga profesori i cdo lënde, si gjatë zhvillimit ë lëndës ashtu edhe pas saj, për cdo problematikë që mund të kenë hasur. Nga komunikimi me studentët, ato e konsiderojnë pikë të fortë komunikimin me stafin akademik.<br><br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 5. Rregullore e UET.<br>Aneks 30.3 Strategjia per sigurimin e brendshem te cilesise.<br>Aneks 40.1. D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve.<br>Aneks 36. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit - BA Infermieri.<br>Vizita ne institucion |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.<br><br>**Kriteri 7.** Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Përsa i përket personeli akademik, (studentët ditën e takimit me GVJ) theksuan, që pedagogët përdorin metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit, me ilustrime të ndryshme dhe duke e lidhur me praktikën. Studentët kanë mundësit të shrpehin dhe komunikojnë lirshëm gajtë orës së mësimit. Ato përfshihen në detyra, ese, ushtrime të ndrsyhme gjatë zhvillimit të programit të studimit. Gjithashtu pedagogët inkurajojnë sensin e autonomisë së studentit, duke siguruar mbështetjen eduhur dhe ndihmuar në ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.<br><br>Aneks 11.4. Plani Sttrategjik per Zhvillimin e Programit te Studimit "Bachelor" NË "Infermieri"<br>Vizita ne institucion<br>Syllabuset e lëndëve |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi III.3**<br>**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat | UET ka në dispozicion të tij në total 7545m$^2$ në adresën e re ku është zhvendosur, në Rrugë "Xhanfize Keko", Nd. 56. Ajo ka hapsira në 3 godina, përkatëesisht në Godinën A 3596m$^2$, Godinën B me 2306 m$^2$ |

| | |
|---|---|
| janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. | dhe Godinën C me 444.8m$^2$, dhe gjithashtu hapsirat e parkingut dhe barit. Në përbërje të tij ka 9 Laboratorë mësimor, edhe pse për programin e studimit ka vetëm një të tillë, fakt që GVJ e konsideron të pamjaftueshëm për zhvillimin e praktikës mësimore për nr e lartë të studentëve të rregjistruar në këtë program studimi. Nga kontrolli bërë, hapsirat ku zhvillohet programi i studimit është I pastër dhe mirëmbahet rregullisht.<br><br>Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko.pdf<br>Vizitë në Institucion |
| **Kriteri 2.** Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor. | UET ka aktualisht në përdorim 45 salla mësimore (17-salla laboratori, 15 salla leksionesh dhe 13 salla Seminaresh). Ambientet universitare janë të mbuluara me sinjal ËiFi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht Ëebin. Të gjitha klasat mësimore janë pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor. Pajisjet dhe programet e instaluara janë risitë e kohës në fushën e teknologjisë së informacionit.<br>Sallat e leksionit ishin funksionale, ambientet e dedikuara për procesin mësimor, ato ishin të pastra dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.<br><br>Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko.pdf<br>Vizitë në Institucion |
| **Kriteri 3.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. | UET ka aktualisht në përdorim 8 salla informatike ( 7 laboratrë informatike dhe 1 sallë internet). Në ditën e vizitës në Institucion vizituam sallën e informatikës, ku Personeli akademik dhe studentët shfrytëzonin sisteme të ndryshme informatike, kishte infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. Ambientet universitare janë të mbuluara me sinjal ËiFi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht Ëebin.<br><br>Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko.pdf<br>Vizitë në Institucion |
| **Kriteri 4.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit. | Biblioteka është e vendosur në Godinën A, salla për bibliotekën me sipërfaqe 40 m$^2$ dhe një salle leximi 50 m$^2$ me 41 vende leximi. Duke ju referuar dokumentacionit për vitin akademik 2021-2022 totali i librave Bruto, Periodik, CD & Harta është 7210 + 2739 në total tituj, ku përfafërsisht gjysma është në gjuhën shqipe dhe gjysma në gjuhë të huaj. Biblioteka njëkohësisht është e pajisur me PC në mënyrë që studentët të aksesojnë bibliotekat online SAGE dhe EBSCO, në të cilat është abonuar institucioni. |

| | |
|---|---|
| | Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko.pdf<br>Vizitë në Institucion |
| **Kriteri 5.** Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. | Biblioteka kishte Literaturë bazë dhe ndihmëse e që u vihej në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), kishte lëndë që si informacion bazë ishte në gjuhë të huaj, gjithashtu sistemi LMS i garantonte studentëve marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.<br><br>Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko.pdf<br>Vizitë në Institucion |
| **Kriteri 6.** Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. | UET ka disa burime të bibliotekës online dhe ato janë 4 platformat:<br>1. Edëard Elgar Publishing<br>2. ASTM Compass<br>3. Sage<br>4. Ebsco<br>Në ditën e vizitës, student pohuan se ata në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, si personeli akademik, ashtu dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. Kjo u deklarua dhe nga Stafi.<br><br>Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko.pdf<br>Vizitë në Institucion |
| **Kriteri 7.** Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. | Ashtu sic jemi shprehur edhe më lartë, institucioni ka një numër të konsdierueshëm laboratoresh, por vetëm një laborator në funksion të programit të studimit, përvec atyre të informatikës ku mund të angazhohen për detyra dhe ese apo edhe thjesht kërkime në fuksnion të programit të studimit. *Studentët dhe stafi u shprehën se ato i zhvillojnë praktikat në ambjentet spitalore, por GVJ është e idesë që Institucioni duhettë ketë hapsirat e nevosjhme brenda isntitucionit për zhvillimin e praktikave lëndëore, përpara se student të shkojë në praktikat profesionale.*<br><br>Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko.pdf<br>Vizitë në Institucion |
| **Kriteri 8.** Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre. | Sallat për leksionet dhe seminaret janë të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni. Laboratorët e informatikës/statistikës janë pajisur me softëaret përkatës në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mirë programit mësimor. Më konkretisht, sistemet e operimit janë të gjithë ëindoës 10, MS TEAMS; paketa Microsoft Office 365 është instaluar e plotë me të gjithë softëaret e |

| | |
|---|---|
| | saj. Ambientet universitare janë të mbuluara me sinjal ËiFi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht ëebin.<br>Personeli Akademik konfirmoi se në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) (LMS) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.<br><br>Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko.pdf<br>Aneks 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.pdf<br>Aneks 46.2. UET LMS Guide per pedagogun.pdf<br>Aneks 46.3. UET LMS Guide per studentet.pdf<br>Vizitë në Institucion |
| **Kriteri 9.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar. | Ambientet universitare janë të mbuluara me sinjal ËiFi në mënyrë që studentët dhe stafi akademik të aksesojnë lirisht Ëebin. Pajisjet dhe programet e instaluara janë risitë e kohës në fushën e teknologjisë së informacionit.<br>Në ditën e vizitës pas takimit me personelin akademik ashtu dhe me studentët, ata konfirmuan se i shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar. Ata u shprehën se pedagogët hedhin detyrat, notat, materiael të dnrsyhme në system dhe studentët gjithashtu futen dhe i aksesojnë ato. Gjithashtu përdorin Teams dhe komunkimet me email mes tyre.<br><br>Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko.pdf<br>Aneks 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.pdf<br>Aneks 46.2. UET LMS Guide per pedagogun.pdf<br>Aneks 46.3. UET LMS Guide per studentet.pdf<br>Vizitë në Institucion |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. | Sipas rregullores së programit të studimit, studenti ka të drejtë të japë provim të përgjithshëm përfundimtarë ose të mbrojë një temë diplome në përfudnim të programit të studimit. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. Kjo gjë është e rregulluar në aktet rregulaltore të vetë isntitucionit.<br><br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri (shqip).<br>Aneks 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.pdf<br>Aneks 7.3. Formati i tezes se provimit perfundimtar.pdf<br>Aneks 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.pdf |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| Standardi III.4<br>**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1**. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. | Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional, sic është KSBC e cila në qëllimin e saj ka rritjen e vazhdueshme të cilësisë dhe veprimtarisë mësimore. KSBC, ashtu sic parashikohet edhe në Statut, është autonome, e përhershme dhe në ran institucional. Kjo strukturë, në bashkëpunim edhe me Departamentet dhe zyrat e tjera të Institucionit, punon për të garantuar cilësinë e mësimdhënies dhe mirfunksionimin e universitetit.<br><br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf8. F.VII Mbi sigurimin e brëndëshëm të cilësisë<br>Aneks 30.3 Strategjia per sigurimin e brendshem te cilesise.pdf |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron. | Njësia kryesore/bazë është Departamenti, i cili përfshin tri sfera të gjera dhe të ndërthurura të aktivitetit: mësimdhënie, kërkim shkencor dhe veprimtari administrative. Ai është përgjegjës përmbajtjen e lëndëve dhe gjithë administrimin e programit të studimit, administron punën kërkimore të departamentit duke bërë kontrolle të stafit përbërës si dhe bashkëpunon me departamente të tjera për realizimin e objektiva të tij. Departamenti, pasi njihet me gjetjet e punës së KSBC-së, por edhe në raste të tjera, organizon mbledhje periodike për të diskutuar rreth problematikave që mund të hasë departamenti.<br><br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 6. Dokument F IV- V mbi organizimin dhe Funksionet e Departamentit. (Ref. Nr. F.V.3.1.) |
| **Kriteri 3.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. | Departamenti si strukturë përgjegjëse në drejtim të të mësimdhënies dhe kërkimit të metodave innovative dhe shkencore. Departamenti është përgjegjës për ndarjen e ngarkesës mësimore, duke përshtatur cdo pedagog me lëndën përkatëse. *GVJ mendon se në këtë rast, pavarësisht vështirësive që mund të ketë hasur insitucioni, duhet të shtojë stafin e kualifikuar në fushën e infermierisë, për të shamngur mbulimin e lëndëve karakterizuese nga staf jo i fushës.*<br>Nga vizita që zhvilluam dhe diskutimet që patëm, stafi deklaron se gjatë procesit të mësimdhënies ato i angazhojnë studentët në diskutime, detyra, ese dhe punë praktike. |

| | |
|---|---|
| | Aneks 6. Dokument F IV- V mbi organizimin dhe Funksionet e Departamentit. (Ref. Nr. F.V.3.1.)<br>Syllabuset e lëndëve<br>Minutat e vizitës |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Personeli akademik është anagazhuar në disa mobility, dhe kjo ka ndihmuar në përmirsimin e mëtejshëm të tyre në drejtim të mësimdhënies. Gjithashtu, stafi nxitet që të marrë pjesë në botime dhe pjesmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.<br><br>Aneks 43. Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit.pdf |
| **Kriteri 5.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. | Në Planin Strategjik per Zhvillimin e Programit te Studimit "Bachelor" në "Infermieri" ndër prioritetet e isnitucionit është edhe trajnimi e vazhdueshëm të stafit akademik. Në fokus janë shkëmbimet e përvojave akademike me institucione të arsimit të lartë dhe institucione kërkimore-shkencore partnere vendase dhe të huaja. Përvec trajnimit që u krye për përdorimin e TEAMS gjatë kohës së pandemisë, *GVJ është e mendimit që vetë institucioni duhet të shtojë numrin e trajnimeve që ajo vetë zhvillon, në kuadër të përmisrismit të mësimdhënies dhe punës kërkimore.*<br>Gajtë pandemisë, stafi deklarojë që mësimi është zhvilluar gati menjëherë në formatin online dhe Teams ka ndihmuar shumë në implemenitmin e metodave të reja në mësimdhënie. Tashmë studentët ndajnë detyrat dhe materialet përmes sitemit, cka lehtëson komunikimin mes tyre.<br>Në cdo rast, studentët u shprehën se janë në komunikim të vazhdueshëm me stafin për kërkesat e tyre në kuadër të përmisimit të meodave të mësimdhënies.<br><br>Aneks 4. Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit "Bachelor në "Infermieri"<br>Aneks 43. Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit.pdf<br>Aneks 46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS.pdf<br>Vizita në institucion. |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. | |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të | Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. |

| | |
|---|---|
| posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Sistemi i vlerësimit Shkalla e përvetësimit të dijeve, me shkrim dhe/ose me gojë, vlerësohet me pikë nga 0-100 pikë dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 (katër) në 10 (dhjetë), si dhe shprehet me germa nga F në A, sipas tabelës së mëposhtme. Notat nga 5 (pesë) në 10 (dhjetë) dhe germat nga E në A janë kaluese.<br><br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri<br>Aneks 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve.pdf |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Në fillim të cdo moduli, stafi akademik prezanton syllabusin dhe aty janë përcaktuar të gjitha elementet, përfshirë edhe menyrën e vlerësimit të modulit. Gjithashtu studentët njoftohen me anë të email-it nga ana kordinatorës së departamentit, por edhe në LMS ku vendosen të gjithë. Vlerësimi i studentëve realizohet në disa komponentë ku përfshihen detyrat/esetë, provimi ndërmjetëm dhe provimi final.<br><br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri.<br>Aneks 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve.pdf |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Në UET zhvillohen dy lloj provimesh, të ndërmjetme dhe përfundimtare. Provimet e ndërmjetme zhvillohen për lëndët e tipologjisë II, në mes të semestrit, ndërsa provimet përfundimtare zhvillohen në fund të semestrit për secilën tipologji lënde. Provimet janë pa pagesë. Provimet zhvillohen si rregull me shkrim. Në varësi të specifikave të lëndës, provimi mund të ketë formën e një projekti ose performance. Në rastin e studentëve me aftësi ndryshe, titullari i lëndës zgjedh formën më të përshtatshme të provimit, sipas përcaktimeve në dokumentin përkatës. 27.4 Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi, e cila ruan anonimatin e studentit deri në korigjimin e tezave nga pedagogu i lëndës.<br><br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri. (Ref. nr. Neni 27 Provimet 27.1)<br>Aneks 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve.pdf |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.6**<br>**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive | Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik. Nota përfundimtare e |

| | |
|---|---|
| profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik. | studentit është një kombinim I vlerësimeve të marra nga provimet e ndërmjetme, provimi përfundimtar dhe një përqindje e mbulon aktivizimi dhe vlerësimet e marra për esetë, projektet apo prezantimet.<br><br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri.<br>Aneks 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve.pdf |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Në UET, falë bashkëpunimit me Albanian American Development Foubndation (AADF), aplikohet një system I ri vlerësimi cleanscoring. Ky system është përdorur në disa provime dhe vlerëson vetëm pjesën e e provimit që plotësohet me alternativa.<br><br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri Neni 27 Provimet |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit. | Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit. Është në gjykimin e titullarit nëse ai preferon që korigjimin e provimit ta bëjë vetë apo në bashkëpunim me asistentë të tjerë pedagogë.<br><br>Aneks 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve<br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri |
| **Kriteri 4.** Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi. | Provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare zhvillohen brenda afatit të caktuar në Kalendarin e Vitit Akademik. Si rregull, provimet e ndërmjetme zhvillohen në javën e 7-të të semestrit me kohëzgjatje normale, ndërsa provimet përfundimtare në fund të semestrit. Provimet janë pa pagesë.<br>Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, e cila firmoset.<br>Skekretaria konfirmon se testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.<br><br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri<br>Aneks 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve |
| **Kriteri 5.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Pas testimit apo cdo lloj vlerësimi, pedagogu është i detyruar të japë një shpjegim për korigjimet e tij, por jo vetëm kjo, studentët kanë të drejtë të shfytëzojnë seancat sqaruese ku mund të shohin me detaje fletët e tyre të provimit si dhe të marrin feedback të drejtëpërdrejtë nga secili pedagog. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik. | Në sallat ku zhvillohen testimet, përvec personave të autorizuar (pedagogu titular, asistentët, sekretaret) nuk lejohen të futen persona të tjerë. Provimi monitorohet vazhdimisht nga 2 persona. Plagjiatura e provuar në paraqitjen e esesë dhe të diplomës ndëshkohet me marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare në disiplinën ose veprimtarinë formuese përkatëse, pavarësisht vlerës së elementeve të tjera vlerësuese.<br><br>Aneks 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve<br>Aneks 5. Rregullore e UET |
| **Kriteri 7.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi, e cila ruan anonimatin e studentit deri në korigjimin e tezave nga pedagogu i lëndës.<br>Vlerësimi i studentit me pikë duhet të jetë i detajuar për çdo pyetje dhe shënohet në fletën e provimit, me bojë dhe në tabelën përmbledhëse të vlerësimit të studentëve. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre, brenda të cilave përfshihen edhe seancat sqaruese.<br><br>Për studentin, që nuk merr pjesë në provimin përfundimtar të lëndës, Sekretaria Mësimore në procesverbalin përfundimtar të lëndës bën shënimin "Nuk u paraqit".<br><br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri<br>Aneks 5. Rregullore e UET |
| **Kriteri 8.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.<br><br>**Kriteri 9.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet. | Studenti ka të drejtë të ankohet për vlerësimit e tij dhe kjo procedurë kalon disa hapa. Si fillim aim und të ankohet tek pedagogu lëndës dhe të presë argumentat e tij/saj. Më pas, nëse akoma nuk është i bidnur, ai mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, për rivlerësimin e kompnentit përkatës. Më pas ngrihet një komision për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vlerësimi që bën komisioni, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar<br><br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri<br>Aneks 5. Rregullore e UET |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.7** |
|---|

<table>
<tr><th colspan="2">Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët,duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</th></tr>
<tr><th>Kriteret</th><th>Vlerësimi i ekspertëve</th></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</td><td>UET-i ofron programe në tri cikle studimi sikurse dhe programe studimi me karakter profesional. Çdo program studimi rregullohet me rregullore të veçantë të programit të studimit. Qëllimi i këtij programi studimi është të pajisë studentët si me njohuri teorike ashtu edhe me ato praktike, ti bëjë ato të aftë për tregun e punës. Por GVJ i qëndron shqetsimeve të bëra në fushën II për stafin e kualifikuar në fushën e infermierisë, shtimin e orëve praktike dhe mos pasjen e një laboratory praktik në ambjentet e isnstitucionit.<br><br>Aneks 7. Rregullore e Programit të BA infermieri, neni 16, pika 16.2 (Ref. nr. 5)<br>Aneks 14. 4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese, BA Infermieri.<br>Aneks 19. Syllabuset e lëndëve</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</td><td>Pjesë kryesore e planit mësimor është fokusuar në fushë ne infemierisë, por studentët e këtij programi studimi gjithashtu marrin njohuri bazë në shekncat humane sociale, sic është edhe Shkrimi akdemik apo Metodat e Kërkimit Shkencor, lëndë që i ndihmojnë ato të jenë kërkues të mirë në të ardhmen. Këto aftësi studenti i zhvillon përgjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve, nëpërmjet përgatitjes së detyrave të kursit dhe detyrave praktike brenda secilës lëndë të programit.<br><br>Aneks 7. Rregullore e Programit të BA infermieri, neni 16, pika 16.2 (Ref. nr. 5)<br>Aneks 14. 4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese, BA Infermieri.<br>Aneks 19. Syllabuset e lëndëve</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</td><td rowspan="2">Studentët, përpara zhvillimit të provimit final konsultohen me pedagogun për tërësinë e lëndës dhe fushat ku duhet të ndalet. Gjithashtu pedagogu, përpara përfundimit të lëndës, kërkon nga student një ese apo detyrë kursi që dëshmon në një farë mënyre edhe njohuritë që ka përthithur ky student nga lënda.<br>Satfi akademik ësht në dispozicion të studentëve përpara provimit final, për të zhvilluar konsulta dhe orientuar studentët në fushat më prioritare.<br><br>Aneks 7. Rregullore e Programit të BA infermieri<br>Aneks 14. 4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese, BA Infermieri.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | Aneks 19. Syllabuset e lëndëve<br>Aneks 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. | Nga shqyrtimi i kalednarit të aktiviteteve 2018-2021, GVJ vëren se është zhvilluar vetëm një leksion i hapur me temën "Psychology of motivation". *GVJ është e idesë që për fushën e infermierisë ka shumë tema interesante dhe novatore që mund të diskutohen në leksionet e hapura, duke ftuar personalitete të fushës, si bredna dhe jashtë dhe institucioni duhet të shtojë përpjekjet për të rritur numrin e tyre.*<br><br>Aneks 14. 4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese, BA Infermieri.<br>Aneks 19. Syllabuset e lëndëve<br>Aneks 55.1 Kalendari i aktiviteteve 2018-2021.pdf. |
| **Kriteri 6.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. | Studentët përgatitet si nga ana teorike ashtu edhe nga ajo praktike. Pjesa praktike, si një element I rëndësishëm I kësja fushe, gjatë kohës që po zhvillohet ky vlerësim, kryhet vetëm në isntitucionet spitalore që ka marrëveshje insitutcioni. *GVJ, pavarësisht se e vlerëson shumë kët eksperiencë që studentët marrin në këto insitucione, është e mendimit që vetë insitucioni duhet të ishte pajisur me laboratorë praktik që studentët të praktikohen. Shpjegime me të detjaura janë dhënën në fushën II.*<br><br>Aneks 14. 4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese, BA Infermieri.<br>Aneks 19. Syllabuset e lëndëve |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara. | Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara. Në secilën lëndë, në javë ne 13 studentët duhet të përgatisin një detyrë kursi në grup, duke rritur kështu bashkëpunimin mes tyre dhe duke dhën mundësinë e ndarjes së detyrave dhe përgjegjësive.<br><br>Aneks 14. 4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese, BA Infermieri.<br>Aneks 19. Syllabuset e lëndëve |
| **Kriteri 8.** Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve. | Nga diskutimet e zhvilluara me studentët, ata shprehen se komunikimi është një ga pikat më të forta të stafit akademik. Ata ndihen të lirë ti drejtohen për cdo pyetje, si per anën mësimore ashtu edhe për atë shkencore. Gjithashtu, stafet akademike mundohen të përfshijnë në projektet e tyre, në punë të vogla dhe të përshatshme për nivelin, edhe studentët. |
| **Kriteri 9.** Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët. | Institucioni e ka pjesë të planit të vet startegjik për kërkimin shekncor shpëndarjen e njohurive kerkimore shkencore te studentët si dhe përfshirjen e tyre në ato. Edhe pse nga bisedat me |

| | |
|---|---|
| | studentët, ata pohojnë se kanë qenë kryesisht dëgjues dhe pjesëmarrës në aktivitetet shkencore dhe nuk kanë publikuar vetë.<br><br>Aneks 3.2. Strategjia e kerkimit shkencor UET 2021-2025.<br>Minutat e takimit. |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Institucioni synon që personeli akademik të ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. Një pjesë e mirë e stafit akademik të UET janë përfshirë në mobility Erasmus, cka I mudnëson atyre të marrin praktikat më të mira europiane dhe ti vendosin në zbatim kur kthehen në UET.<br><br>Aneks 43. Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi III.8**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. | Studentët kanë mudnësi që të mbrojnë diplomën ose me punim diplome ose me provim përfundimtar. Studentët njihen me te gjithë këto njohuri që në fillim si nga pedagogët, si nga dokumentat rregullatore që UET ka për këto procedura.<br><br>Aneks 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve.pdf<br>Aneks 7.3. Formati i tezes se provimit perfundimtar.pdf<br>Aneks 7. Rregullore e Programit të BA infermieri<br>Aneks 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.pdf |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. | Pasi miratohet tema e diplomës dhe pedagogu udhëheqës, student ndiqet hap pas hapi deri në mbrojtje. Gjithashtu në punën e studentit, deri në përzgjedhjen e temës, merr sugjerime dhe këshillohet nga tutori dhe këshillimi akademik që janë në shërbim të studentëve, për të sqaruar çdo paqartësi ose vështirësi që mund të haset nga studenti për shlyerjen e detyrimeve që ka secili.<br><br>Aneks 5. Rregullore e UET<br>Aneks 7.3. Formati i tezes se provimit perfundimtar.pdf<br>Aneks 10. Dokumenti. BII. Mbi punimin e diplomës dhe dizertacionit. |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha | Studenti mudn të diplomohet ose duke mbrojtur një temë diplome (që duhet të ketë një mesatare prej 8.5 të tre viteve) ose duke dhënë një provim përfudnimtar që përfshin të gjithë njohuritë që duhet të ketë marrë student në 3 vite. Të gjitha këto njohuri studenti i |

| | |
|---|---|
| lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | merr që në fillim të vitit nga pedagogu por edhe nga njësitë tjera admisnitrative.<br><br>Aneks 5. Rregullore e UET<br>Aneks 10. Dokumenti. BII. Mbi punimin e diplomës dhe dizertacionit. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave. | Studentë përfitojnë nga tutoriati dhe këshillimi i karrierës gjatë gjithë vitit, për cdo detyrë, provim, apo pyetje të natyrave tjera mësimore, dhe në fund atij përsëri i ofrohet një mbështetje nga stafi akademik dhe ai adminsitrativ në përfundimin e programit të studimit. Ata kanë të drejtë të kosnudlothen si për provimin përfudnimtar, duke evidentuar pikat kryesore ku duhet te fokusohen, por edhe të ndiqen nga një pedagog udhëheqës për punimin e diplomës kur e kanë zgjiedhur.<br><br>Aneks 27.2 Mbi tutoriatin dhe këshillin akademik<br>Aneks 5. Rregullore e UET<br>Aneks 10. Dokumenti. BII. Mbi punimin e diplomës dhe dizertacionit. |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Në vizitën në institucion, studentët deklaruan se ato asistohen për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. Por nëse student ka nevojë që të marrë inforormcacione në disa struktura të tjera, jashtë UET, institucioni lëshon një vërtetim që ndihmon në pajisjen e studentit me këtë informacion. |
| **Kriteri 6.** Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet), ndihmon dhe asiston studentin në disa aspekte, që nga metodoligjia e zgjedhur për trajtimin e temës, përpunimin e të dhënave, punët në terren dhe raportimin e gjetjeve, hartimin dhe strukturën e punimit etj, deri në përfundim dhe dorëzimin e saj. Tema e diplomës nuk mund të mbrohet nëse nuk ka kaluar më parë për miratim nga udhëheqësi i saj.<br><br>Aneks 27.2 Mbi tutoriatin dhe këshillin akademik<br>Aneks 5. Rregullore e UET<br>Aneks 10. Dokumenti. BII. Mbi punimin e diplomës dhe dizertacionit |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me note, e cila është një mesatare e vlerësimeve të anëtarëve përbërës të komisionit vlerësues.<br><br>Aneks 5. Rregullore e UET<br>Aneks 10. Dokumenti. BII. Mbi punimin e diplomës dhe dizertacionit |
| **Kriteri 8.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. | Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. GVJ u njoh me kuadrin ligjor më mirë në vizitë për faktin |

| | |
|---|---|
| | që studentët e këtij programi studimi nuk mund të pajisen me diplomë para se të merret vendimi rreth akreditimit të tij.<br><br>Minutat e Takimit |
| **Kriteri 9.** Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. Kjo është e përfshirë në programin që studenti merr në fund të studimit si dhe suplementin perkatës, në gjuhën shqipe dhe atë angleze.<br><br>Aneks 5. Rregullore e UET<br>Aneks 10. Dokumenti. BII. Mbi punimin e diplomës dhe dizertacionit |
| **Kriteri 10.** Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. | Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.<br>Nga informacioni marrë nga sekretaria ditën e vizitës në i institucion, këto dokumente ruhen në tre vjet.<br><br>Minutat e Takimit |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe | Zyra e Burimeve njerëzore ruan dhe përditëson të gjitha dosjen e personelit akadmeik, me kohë të plotë dhe me kohë t pjesshme. Nga vizita zhvilluar në ambjentet e UET dhe takimit me përgjegjësen e Burimeve Njerëzore, GVJ u njoh me dosjet individuale e stafit dhe evidentoi ruajtjen e dokumentave të nevosjhme për secilin pedagog.<br><br>Aneks 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore. |

| | |
|---|---|
| atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ. | Aneks 44.1. Format dosje staf akademik me kohë të plotë.<br>Aneks 44.2. Format dosje staf akademik me kohë të pjesshme. |
| **Kriteri 2.** Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. | UET ka një rregullore që përfshin në mënyrë të detajuar procesin e rekrutimit të stafit akademik. Në këtë rregullore përcaktohen Politikat dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik; Kriteret e shpërndarjes së ngarkesës mësimore; Trajtimi i rasteve të ekselencës së personelit apo dhe Kriteret dhe procedurat e marrjes lejë në UET, etj. Kjo procedurë u konfirmua edhe gajtë bisedës në isnitutcion me përgjegjësen e zyrës.<br><br>Aneks 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore. |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike. | Departamenti është njësia bazë që inicion kërkesën për mbulimin e vakancave, duke përcaktuar edhe kriteret e posacme në varësi të pozicionit. Pasi merret miratimi nga Dekani, atëherë zyra burimeve njerëzore procedon me publikimin në faqen ëeb dhe rrjetet sociale.<br>Në përzgjedhjen e kandindave zbatohen me korrektësi të gjitha elementet e rregullores duke respektuar të gjithë kriteret e përgjithshme dhe të posacme, dhe më pas në mënyrë transparente përzgjidhet kandidadi fitues.<br><br>Aneks 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore. |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efiçente dhe efektive** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. | Ambjentet e punës janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për realizimin e detyrave nga ana e stafit akademik. Pavarësisht se institucioni ka vetëm 1 vit që është larguar nga ambjentet e tij të mëparshme, ku kishte edhe më shumë hapsira, GVJ është e idesë që edhe në kushtet aktuale, mjedisi i punës është i përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit tyre.<br><br>Vizitë në institucion.<br>Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko.pdf |
| **Kriteri 2.** Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të | Institucioni realizon disa nisma të cilat angazhojnë dhe nxisin stafin akademik për zhvillim profesional. Institucioni mbështet, |

| | |
|---|---|
| personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. | përmes skemës së financimit të kërkimit shkencor, stafin akademik që realizon botime të artikujve shkencor të indeksuara në Thomson-Reuters. Stafi përfshihet në organizimin dhe realizimin e konferencave shkencore, projekteve kërkimore, mobilitete në kuadër të programit Erasmus + etj.<br><br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 3.2. Strategjia e kerkimit shkencor UET 2021-2025. |
| **Kriteri 3.** Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. | Gjatë pandemisë I gjithë stafi akademik u trajnua për përdorimin e platformave online. Institucioni mundëson dhe trajnimin e stafit akademik nga zyra e TIK mbi programet LMS. Gjithashtu marrja pjesë e stafit në programet Erasmus + krijon mundësi për të përfituar nga eksperienca dhe shkëmbimi i metodave innovative të mësimdhënies.<br><br>Aneks 46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS. |
| **Kriteri 4.** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë. | Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit në përgjithësi kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, *por GVJ ka evidentuar lëndë të profesionit që nuk jepen nga pedagogë të diplomuar në fushën e Infermierisë. Pedagogët kanë detyrimin primar të të jenë të diplomuar në diplomën përkatëse, pasi cdo pershtatje e leksioneve nuk do të ishte efikase për studentët.* Për vitin akademik 2020-2021, stafi përgjegjës për këtë program studimi ndahet në 17 Staf akademik efektiv (PAE) me 2 Prof. Dr,1 Prof. Asc., 8 Dr , 6 Msc dhe 5 Staf akademik me kontratë (PAK) me 2 Dr dhe 3 Msc. Ngareksa më e madhe ë programit të studimit mbulohet nga stafi akademik efektiv, ashtu sic e kërkon edhe ligji.<br><br>23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit (Aneks_Tabela 1dhe 2)<br>0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - BA Infermieri<br>CV e stafit akademik |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi IV.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | GVJ konstaton se institucioni ka mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për realizimin e proceseve akademike. Institucioni ka salla të kapaciteteve të ndryshme të ndara në salla leksionesh, seminaresh, zyra dhe laboratore. Pavarësisht se insitucioni ka në dispozicion një infrastrukturë fizike, didaktike dhe logjistike për përmbushjen e realizimit të programit të studimit, *GVJ i qëndron mendimit se është i nevojshëm një laboratorë i dedikuar programit të studimit në ambjentet e isnitucionit.*<br><br>Vizitë në institucion.<br>Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Në UET, auditorët janë të pajisur me mjete audio vizive si PC, projektor, internet dhe foni. Infrastruktura në dispozicion të procesit mësimor për programin e studimit Bachelor në Infermieri garanton realizimin e procesit mësimor në ksuhte të favorshme për studentët. GVJ e kupton situatën që institucionit iu desh të ndryshonte vendndodhje shumë shpejt, dhe nga bisedat e kryera u konfirmua se plani është që edhe ambjentet ku ndodhen momentalisht janë provizore, duke qenë se UET po punon për realizimin e një kampusi gjithëpërfshirës.<br><br>Vizitë në institucion.<br>Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Pavarësisht se në ambjentet ku zhvillohet mësimdhënia janë disa laboratorë informatike, të pajisur me teknologjinë e duhur, *GVJ i qëndron idesë se është e nevojshme pajisja me një laboratorë të dedikuar profilit të programit të studimit, duke qenë se aspekti praktik është shumë i rëndësishëm për të.*<br><br>Vizitë në institucion.<br>Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko |
| **Kriteri 4.** Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron. | Institucioni ka në dispozicion disa laboratorë informatikë, të cilët janë në dispozicion të programeve të studimit të ciklit parë dhe të dytë. Ato janë pasjisur me të gjithë elementet e nevojshëm për një laboratorë informatike.<br><br>Vizitë në institucion.<br>Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të | Kapacitetet e UET dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera mundësojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e veprimtarive praktike dhe aktiviteteve të tjera. |

| | |
|---|---|
| posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. | Studentë kryejnë praktikën e tyre në disa spitale publike dhe private në vend.<br><br>Aneks 34. Marrëveshjet e bashkëpunimit UET |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Institucioni garanton të drejtën e studentit për aksesimin e biblotekës përmes procedurës së regjistrimit dhe hapjes së kartelës për shfrytëzimin e literaturës fizike dhe jashtë ambjenteve të saj. Cdo student mund ta përdorë atë në orarin e përcaktuar dhe mund të konsultohet me të gjithë titujt fizikë dhe ato elektronikë.<br><br>Vizitë në institucion.<br>Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko<br>Aneks 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.pdf |
| **Kriteri 2.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Gajtë vizitës, GVJ verifikoi haspirat e biblioteksë dhe fondin që ajo përmbante. Për shkak të ndryshimit të ambjenteve, ka ndikuar edhe ne zvogëlimin e hapsirave për bibliotekën. Nga biseda me përgjegjësen e bibliotekës na konfirmoi se një pjesë e librave qëndrojnë në kutia akoma dhe janë në proces hapje dhe përshtatje në bibliotekë. Gjithsesi në ambjentet e bibliotekës kishte material fizikë në të dy gjuhët, si në atë shqip, ashtu edhe në atë angleze.<br><br>Vizitë në institucion.<br>Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko<br>Aneks 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.pdf |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit. | Sipas komunikimeve në terren por edhe RVB, UET ka lidhur marrëveshje me disa library online sic janë Sage, Ebsco dhe Questia, ku studentët mund të aksesojnë ato edhe në ambjentet e bibliotekësa duke qenë se ishte pajisur me disa poste me PC dhe qasje në internet.<br><br>Vizitë në institucion. |

| | |
|---|---|
| | Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko<br>Aneks 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.pdf |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. | Pervec aksesit që studentët mund të kenë libraritë online në haspirat e bibliotekës, ato gjithashtu kanë qasje në sistemin COBISS, pjesë e së cilës është edhe biblioteka e UET. COBISS është një rrjet ku janë përfshirë të gjithë vendet e rajonit të Europës Juglindore e cila lidh të gjithë bibliotekat për të mundësuar një katalogim të përbashkët të gjithë titujve që kanë bobliotekat pjesëmarrëse dhe në vecanti secila.<br><br>Vizitë në institucion.<br>Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko<br>Aneks 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.pdf |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit. | UET-i ndjek një praktikë të pasurimit të fondit të biblotekës sipas kërkesave që vinë nga njësitë bazë. Përgjegjësit e programit të studimit përmes kërkesave të marra nga stafi akademik me titujt e propozuar i përcjellin më tej në Dekanat duke filluar procedurën. Realizimi i procedurës për pasurimin e fondit realizohet në mënyrë periodike.<br><br>Aneks 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.pdf<br>Aneks 45.2. Formular per pasurimin e fondit te librave ne biblioteke.pdf Aneks 45.3. Shembull procedure_blerje literature.pdf |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Bibloteka qëndron e hapur nga e hëna në të shtunë. Përgjatë javës orari i funksionimit të biblotekës është 09.00-20.00 dhe ditën e shtunë qëndron e hapur deri në orën 17.00. Oraret e bibliotekës ishin në përshtatje të orareve mësimore.<br><br>Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko<br>Aneks 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.pdf |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët | UET ka një sistem të menaxhimit të informacionit të quajtur UMIS. Përmes këtij programi informatik realizohet ruajtja, administrimi dhe përpunimi i të dhënave të studentit nga |

| | |
|---|---|
| dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | regjistrimi deri në diplomim. Ky system përmban edhe nje hapsire per studentet te cilet aty mund te gjejne informacione rreth notave, rezultatet, informacione personale etj.<br><br>Aneks 46. Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS.<br>Aneks 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.<br>Aneks 46.2. UET LMS Guide per pedagogun.<br>Aneks 46.3. UET LMS Guide per studentet. |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.<br><br>**Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.<br><br>**Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | Platforma që përdor institucioni mundëson komunikimin, informacionin dhe materialet që lidhen me procesin mësimor ndërmjet stafit akademik dhe studentëve në kohë reale. Secili aktore, stafi akademik/adminstrativ dhe studentët, kanë askes te tyre individual dhe secili mund ta përdorë platform për detyrat e tij. Studentët marrin informacione rreth ecurisë tyre akademike por edhe njoftime të tjera ndërsa stafi akademik dokumenton punën e tij.<br>Përmes kësaj platforme, ndjekja dhe kontrolli i punës dhe përmbushjes së detyrimeve nga ana drejtuesve është më prekshme duke qenë se ka gjurmë për cdo veprim. Rezultatet pozitive të përdorimit të këtij sistemi u panë më shumë gjatë pandemisë, me lehtësimin e komunikimit në kohë reale mes stafit, studentit dhe IAL-se<br><br>Aneks 46. Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS.<br>Aneks 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.<br>Aneks 46.2. UET LMS Guide per pedagogun.<br>Aneks 46.3. UET LMS Guide per studentet. |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. | Platforma LMS mundëson monitorimin e aktivitetit akademik nga strukturat e KSBC-së dhe jo vetëm. Sistemi i menaxhimi UMIS garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale.<br><br>Aneks 46. Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS.<br>Aneks 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.<br>Aneks 46.2. UET LMS Guide per pedagogun.<br>Aneks 46.3. UET LMS Guide per studentet. |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe. | Faqa zyrtare e UET përmban informacion të larmishëm. Inforamcionet që shfaqen në faqen zyrtare janë pjesë e cdo dokumenti zyrtar që është fuqi në këtë institucion. Aty kupton qartë strukturën organizative, programet që ofrohen, të dhëna, facilitate e tj.<br>Faqja është e aksesueshem në dy gjuhë, në atë shqipe dhe angleze.<br><br>https://uet.edu.al/en/ |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi IV.6<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | GVJ konstaton se raporti financiar hartohet në nivel institucioni gjatë muajti tetor të çdo viti dhe për zbatimi ne këtij buxheti ngarkohet për zbatim administratorti dhe zyra financës. Raporti nuk është i ndarë sipas programeve specifike. Cdo lëvrim është e strukturuar dhe kalon nga zyra financës, dhe më pas miratohet nga administratori.<br><br>Aneks 50.3 Pasqyrat Financiare 2020 me shënime.<br>Ankes 50.6 Raport auditimi viti 2020. |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij. | Ashtu sic u theksua edhe më lartë, ky raport është i hartuar në nivel insitiucional dhe nuk ndalet në secilin program specific. Sipas RVB-së, GVB është shprehur që për përmasat e isntitucionit, ky kriter ëshët vështirë të përshtatet për cdo program studimi në mënyrë specifike. Gjithsesi raporti është i detajaur dhe përfshin një gamë të gjerë elementësh në të.<br><br>Aneks 50.3 Pasqyrat Financiare 2020 me shënime.<br>Ankes 50.6 Raport auditimi viti 2020. |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. | Për këtë kriter GVJ është bazuar në raportin e audituesit të pavarur, ku shprehet në mënyrë pozitive në lidhje me situatën financiare, performancën, bazuar në standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Ky vlerësim kryehet cdo vit dhe në mënyrë peridoke dhe kjo tregon në mënyrë të drejtë stabilitetin e këtij intitucioni. UET ka ngarkuar në dokumentat ku GVJ është mëbshtetur, raportet e auditit dhe pasqyrat financiare për 3 vitet e fundit. |
| **Kriteri 4.** Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. | |

| | |
|---|---|
| | Aneks 50.3 Pasqyrat Financiare 2020 me shënime.<br>Ankes 50.6 Raport auditimi viti 2020. |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. | GVJ duke marrë në kosnideratë pasqyrat financiare dhe vlerësimet e audituesit të pavarur, është e mednimit që UET garanton qëndrueshmëri financiare për mbarëvatjen e këtij programi studimi, por dhe në nivel insitucional. Gjithashtu, duke pasur në kosnideratë edhe tregun dhe kërkesën e lartë për infermierë, numrat e të rregjistruarve janë në nivel të kënaqshëm.<br><br>Aneks 50.3 Pasqyrat Financiare 2020 me shënime.<br>Ankes 50.6 Raport auditimi viti 2020. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | I gjithë kuadri ligjor regullator që UET ka në fuqi, ku janë statuti dhe një sërë rregulloresh, mundësojnë mbulimin e cdo cikli studimi nga fillimi në fund. Në dokumentin "Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve" bëhet e qartë politika që ndjek institucioni dhe kriteret e pranimit për të tre ciklet e studimit që ofron ky universitet. Politikat e ndjekura në institucion janë konform legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatore të universitetit.<br><br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 5. Rregullore e UET.<br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri (shqip).<br>Aneks 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve. |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të | Në bazë të dokumentacionit të shqyruar si: Statutit UET, Rregulloren e UET, Rregullore e Programit MSH Studime Religjoze, rezulton se politikat dhe procedurat e ndjekura nga |

| | |
|---|---|
| gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | UET përsa i takon pranimit dhe përfundimit të studimeve janë të njëjta për të gjithë studentët.<br><br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri (shqip).<br>Aneks 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin_BA Infermieri.<br>Aneks 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve. |
| **Kriteri 3.** Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Në dokumentacionin e shqyrtuar si Statuti i UET, Rregullore e UET dhe dokumenta të tjerë, vërehet që kriteret dhe procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes janë të kuptueshme dhe të aksesueshme. Studenti mund të informohet si nga vetë dokumentat që janë publike por edhe nëpërmjet konsultave që marrin direkt nga tutori, drejtuesit, apo edhe vetë stafi akademik.<br><br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 5. Rregullore e UET.<br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri (shqip).<br>Aneks 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin_BA Infermieri.<br>Aneks 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.<br>Aneks 28. Dokumenti D.II mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin. |
| **Kriteri 4.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.<br><br>**Kriteri 5.** Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. | Përpara fillimit të regjistrimit institucioni bënë publike kriteret dhe procedurën e pranimit për programet e cikleve të ndryshme të studimit. Uet respekton aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, akte që janë pasyqruar edhe në dokumentat rregulluese të brednshme. Kriteret specifike (nëse ka) propozohen nga Departamenti dhe miratohen nga Senati Akademik. Ky informacion është i aksesueshëm pasi publikohet në faqen zyrtare të universitetit.<br><br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 5. Rregullore e UET.<br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri (shqip).<br>Aneks 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin_BA Infermieri.<br>Aneks 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.<br>Aneks 55.1 Kalendari i aktiviteteve 2018-2021. |
| **Kriteri 6.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | Institucioni ka disa forma të informimit dhe orientimit mbi kërkesat e kriteret që ka programi i studimit si: takimet informuese në institucion; përdorimi i faqes zyrtare; rrjeteve sociale etj. Gjithashtu, për studentët ëe rinj që vijnë për herë të parë në insitucion është edhe java e orientimit, ku studentët njihen me të gjithë infrastrukturën e UET por edhe me materialet qe do të punojnë.<br><br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 5. Rregullore e UET.<br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri (shqip). |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| | Aneks 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin_BA Infermieri.<br>Aneks 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.<br>Aneks 55.1 Kalendari i aktiviteteve 2018-2021. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Në dokumente të tilla si Rregullore e UET apo Rregullore e programit të studimit BA infermieri, dhe dokumeta të tjera rregullatore, gjëndet informacioni mbi kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentit. Sitemi UMS dhe LMS gjithashtu mund të shfytëzohen për këtë qëllim. Studenti mund të informohet edhe pranë sekretarisë mësimore apo tek koordinatori i programit të studimit mbi përparimin e tij akademik. informacionit.<br><br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 5. Rregullore e UET.<br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri (shqip).<br>Aneks 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin_BA Infermieri.<br>Aneks 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.<br>Aneks 55.1 Kalendari i aktiviteteve 2018-2021. |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Pervec akteve rregullatore (Statut, Rregullore UET, Rregullore programi etj), Institucioni informmon studentët edhe nëprmjet strukturave të tij administrative. Zyra ndaj Kujdesit të studentit në bashkëpunim me Departamentin informojnë dhe lehtësojnë studentin me vlerësime paraprake për transferim studimesh apo njohje të tyre.<br><br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 5. Rregullore e UET.<br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri (shqip).<br>Aneks 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin_BA Infermieri.<br>Aneks 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.<br>Aneks 55.1 Kalendari i aktiviteteve 2018-2021. |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e | Studentët mund të informohen vetë nëpërmjet dokumentave rregullatore që ka UET, por në cdo rast, Në fillim të çdo semestri |

| | |
|---|---|
| aftësive të studentëve në programin e studimit. | studentët informohen nga stafi akademik mbi procedurat e vlerësimit të dijeve.<br><br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 5. Rregullore e UET.<br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri (shqip).<br>Aneks 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin_BA Infermieri.<br>Aneks 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.<br>Aneks 55.1 Kalendari i aktiviteteve 2018-2021. |
| **Kriteri 4.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Studentë kanë mundësi të diplomohen si me provim të përgjithshëm ashtu dhe me mbrojtje teme. Në të dyja rastet, Institucioni ka akte rregullatore që ndihmojnë studentin në avancimin e tij akademik. GVJ u infomua nga takimi me anëtarët e GVB dhe nga takimi me studentët për zbatimin konkret të këtij procesi.<br><br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 5. Rregullore e UET.<br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri (shqip).<br>Aneks 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.<br>Aneks 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin_BA Infermieri.<br>Aneks 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.<br>Aneks 55.1 Kalendari i aktiviteteve 2018-2021. |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | UET, me satfin e tij akademik mban kontakte dhe zhvillon prezantime të dnryshme në shumë gjimnaze të vëndit si dhe Open Day, ku ftohen të gjithë maturatnët të shikojnë nga afër ofertën akademike të UET. Gjithashtu për studentët e rinj organizohet edhe Java e Orientimit, duke i njohur ato me cdo strukturë dhe specifikat e tyre.<br><br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 5. Rregullore e UET.<br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri (shqip).<br>Aneks 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin_BA Infermieri.<br>Aneks 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.<br>Aneks 55.1 Kalendari i aktiviteteve 2018-2021. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Standardi V.3**
**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| --- | --- |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. | Studentët kanë disa mënyra informimi për orgazimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Ata mund të konsultohen me aktet rregullatore, syllabuset, planin mësimor etj, mund të marrin informacion nga Zyra e kujdesit ndaj studentit, dhe sigurisht komunikimet me stafit akademik, që nga vizita që zhvilluam ishte një pikë e fortë që studentët shprehnin për to.<br><br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 5. Rregullore e UET.<br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri (shqip).<br>Aneks 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin_BA Infermieri.<br>Aneks 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.<br>Aneks 55.1 Kalendari i aktiviteteve 2018-2021. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Që në momentin e regjistrimit, studenti pajiset me numër matrikullimi dhe gëzon të gjitha të drejtat e studentit. Ai pajiset me informacionin e duhur që lidhet me programin e studimit që përmban lëndët dhe modulet e tij. Institucioni e shpërndan këtë informacion nga disa burime, nga stafi akademik, sistemi LMS/faqja Ëeb dhe komunikimet me zyrat përkatëse.<br><br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 5. Rregullore e UET.<br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri (shqip).<br>Aneks 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin_BA Infermieri.<br>Aneks 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.<br>Aneks 55.1 Kalendari i aktiviteteve 2018-2021. |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës. | Institucioni ka disa struktura që adresojnë vënien në kontakt të studentëve me mundësitë e punësimit. Zyra e Këshillimit të Karrierrës dhe Kujdesit të Studentëve bënë njoftime për mundësi punësimi, por edhe organizimet epanairit të punës shërbejnë shumë për të krijuar lidhjen mes tregut të punës dhe studentëve të UET.<br><br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 5. Rregullore e UET.<br>Aneks 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf<br>Aneks 12.3. Poster_Panairi i punës 2018 dhe 2019.pdf<br>Aneks 55.1 Kalendari i aktiviteteve 2018-2021. |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Në takimin e realizuar me studentët e programit BA në Infemieri u vërejt fakti se ata vlerësonin sistemin LMS dhe komunikimi insitucional. Sipas tyre stafi akademik, por dhe ai administrativ ishin gjithmonë të gatshëm për tiu përgjigjur pyetjeve të tye. Gjithashtu, sistemi LMS u krijonte shumë lehtësi në komunikimin |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet permes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance. | me stafin akademik të angazhuar në program, aksesin e leksioneve në formatin elektronik dhe çdo informacion tjetër që lidhet me organizimin e programit mësimor.<br><br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 5. Rregullore e UET.<br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri (shqip).<br>Aneks 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.pdf<br>Aneks 55.1 Kalendari i aktiviteteve 2018-2021.<br>Vizita në Insitucion |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi. | Sipas akteve regulaltore të UET, regjistrimi i studentëve bëhet në katër regjistra: themeltar, i amzës, i diplomave, dhe i lëndës, të cilët mbahen në formë elektronike dhe në formë të shkruar. Nga kontrolli rastësor i rregjistrave, rezulton se të dhënat mahet në mënyrë korrekte dhe me kujdes. Edhe sekretari ka askesin e vet në sistemin LMS dhe kryen aty prcedurat që ka tagrin të kryej. Institucioni dispononte të dhënat e studentëve të programit të studimit në fjalë.<br><br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 5. Rregullore e UET.<br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri (shqip).<br>Aneks 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin_BA Infermieri.<br>Aneks 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.pdf |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | GVJ iu vu në dispozicion të dhëna që lidheshin me numrin e studentëve të registruar në program, ata që ishin çregjistruar dhe ata që ishin me status aktiv. Sistemi UMIS mundëson që të dhënat statistikore të përpunohen në cdo kohë, duke filluar që nga viti i parë akademik i UET, 2006-2007.<br><br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 5. Rregullore e UET.<br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri (shqip).<br>Aneks 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.pdf |
| **Kriteri 3.** Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë | Cdo student i rregjistruar në UET ka dosjen e vet persoanle me dokumentat e dorëzuar në rregjistrim. GVJ, në takimin e |

| | |
|---|---|
| zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. | realizuar pranë sekretarisë mësimore, pa nga afër dosjen e një studenti, e cila përmbante të gjitha dokumentat e duhura si: diploma dhe lista e notave e noterizuar, kontrata, ID etj. Përzgjedhja e saj u bë në mënyrë rastësore. Pervec dosjes, të dhënat dhe arritjet e tij akademike rezultonin të hedhura në mënyrë korrekte në sistemin elektronik dhe rregjistrat fizikë.<br><br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 5. Rregullore e UET.<br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri (shqip).<br>Aneks 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin_BA Infermieri.<br>Aneks 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.pdf |
| **Kriteri 4.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Sistemi UMIS i sekretarisë është funksional prej shumë kohësh dhe garanton sigurinë e duhur. Ajo mund të aksesohet nga personat përgjegjës me anë të username tyre dhe passëord-in personal. Zyra e IT-së është përgjegjëse për administrimin e të dhënave në sistem.<br><br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 5. Rregullore e UET.<br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri (shqip).<br>Aneks 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin_BA Infermieri.<br>Aneks 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.pdf |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | GVJ përpara vizitës në institucion është njohur me një sërë shifrash rreth studentëve të vendosura në tabela të detajuara, cka tregon mundësinë e institucionit për ti hartuar ato. Gjithashtu, gjatë vizitës, në praninë tonë personi përgjegjës në sekretari na dëshmoi sesi mund të gjeneronte tabela të dhënash.<br><br>Aneks 2. Statuti UET.<br>Aneks 5. Rregullore e UET.<br>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit BA Infermieri (shqip).<br>Aneks 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin_BA Infermieri.<br>Aneks 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.pdf |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi V.5<br>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e | Studentët janë të përfshirë në disa struktura drejtuese në UET dhe marrin pjesë intensivisht në to. Përfaqësuesit e studentëve përfshihen në struktura si: Senati Akademik; Këshilli i |

| | |
|---|---|
